

Tashko Lako

BIBLIOTEKA
SHYTETIT

B34-3
L18



NOVATORI ME TAKIJE

OSH-7
L19

TASHKO S. LAKO

NOVATORI ME TAKIJE

(Tregime dhe skica humoristike)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KËSHTU MENDOJ UNË...

Unë jam unë dhe, meqenëse jam unë, këtu ku jam unë dhe komandoj unë, do të bëhet kështu si mendoj unë. Qartë? Qartë thuaj. Atëherë dëgjoni:

Po e filloj me ju, shoku agronom. Unë mendoj se studimi juaj, që ka të bëjë me studimin e tokave, do studjuar me kujdes, sepse pa një studim të tillë të këtij studimi kaq shumë të rëndësishëm, çështja e studimit të tokave mbetet në themel e pastudjuar dhe kjo i sjell një dëm të pakrahasueshëm vetë problemit të studimeve. Kështu pra, i dashur, meqenëse për të studjuar imtësisht e me tërë seriozitetin e duhur studime të tilla duhet kohë, dhe ne tani nuk kemi kohë, po e lëmë këtë çështje për një kohë kur të kemi kohë. Atëherë gjithçka do të zgjidhet në kohë, sepse do të shqyrtohet pikërisht në kohë. Kështu mendoj unë...

Dy fjalë edhe me ju, shoku zooteknik. Unë mendoj se propozimi juaj, që na tërheq vëmendjen lidhur me vëmendjen që duhet të tregojmë për sigurimin e bazës ushqimore, meriton një vëmendje të posaçme, po fatkeqësisht sot ne nuk mund ta përqëndrojmë dot vëmendjen tonë në këtë problem, që kërkon kaq shumë vëmendje, për shkak se e kemi drejtuar vëmendjen në të tjera drejtime, ku pa një vëmendje të vëmendshme nuk mund të nxirret asgjë në shesh. Kështu mendoj unë...


Ju, shoqe, na lejoni t'i biem ca si shkurt, që të mos

e qarkosim gjatë e gjatë e ta bëjmë mullar si litar gjemie. Ju kërkoni të çelen çerdhe e kopshte për fëmijë në çdo brigadë, në mënyrë që të dalin në punë të gjitha nënat me fëmijë? Unë mendoj se ju e keni mirë që e shtroni këtë problem, për faktin se vetë ngritja e çerdheve dhe e kopshteve është një gjë e mirë por, që në çerdhe e kopshte punët të na shkojnë sa më mirë, do të jetë më mirë që të mendohemi njëherë mirë e mirë në është mirë që t'i ngremë këto çerdhe e kopshte mot e jo sot, që kështu gjithçka të na shkojë mirë. Mirë? Mirë thuaj. Ja, kështu mendoj unë...

Po ti, o vëlla i vogël? Të dërgojmë ushqim në brigadë, thua? More, more, more! E di që mirë thua! E, meqë thua mirë, ja ku po ta them edhe unë se, këto që thua, do t'i kem parasysh, që t'i them atëherë kur duhen thënë. Sot për sot nuk kemi nge të themi të tilla. Bukur e thashë? Bukur thuaj. Kështu mendoj unë...

Hë, o shoku brigadier? Nxirre të shkretën, e mos e mbaj ballgëm? Ti mendon se duhet të bëjmë specializimin e kulturave. Ky është një mendim special, që kërkon një specializim të veçantë e që është i lidhur ngushtë me specializimin e njerëzve dhe të tokës. E tërë kjo e marrë së bashku kërkon një punë speciale, që hëpërhë ne as që kemi mundësi ta mendojmë e le pastaj ta zbatojmë. Kështu mendoj unë...

Ka edhe një pyetje: Ç'të bëjmë, të paravadihim e pastaj të mbjellim, apo të mbjellim e më pas të vaditim? Agronimi thotë të paravadihim. Brigadieri thotë të mbjellim më të thatë. Pleqtë na këshillojnë të thyejmë plisat me tokmak, ndërsa traktoristët ngulin këmbë të përdorin branën e rëndë. Edhe ashtu, edhe kështu. Edhe kështu, edhe ashtu. Asnjëri nuk i bie shkurt e nuk e prek thelbin e çështjes. Këtë po e bëj unë. E shihni? Në qiell po duken re nuplore dhe qafa e rosakut po mbyllet. Koskat



po më çajnë e kryqëzet më janë mbërthyer aq ters, saqë nuk po i luaj dot. Kjo do të thotë se shiun e kemi në prak të derës. Pra të mos mbjellim po të prashitim. Qartë? Qartë thuaj. Kështu mendoj unë...

Po një ditë i thanë:

— Kështu mendon ti? Të dëgjuam. Tani, na dëgjo edhe ne.

Dhe folën me radhë.

Agronomi: — Studimin e tokave e përfunduam. Pas-këtaj duhet të mbjellim në përputhje me të dhënat agrope-dologjike. Kështu mendojmë ne.

Zootekniku: — Planin e mbjelljeve të foragjereve e plotësuam. Edhe sillazh kemi bërë mjaft. Edhe koncentrate kemi. Blegtorinë tani duhet ta ushqejmë në bazë të një racioni të studjuar. Kështu mendojmë ne.

Një shoqe: — Këshilli popullor vendosi të çelë kopsh-tin dhe çerdhen në sektorin tonë, ndërsa ju, shoku përgjegjës, duhet të lëshoni një urdhër për t'i pajisur ato me materialet e nevojshme. Mjaft më me zvaritjet. Kështu mendojmë ne.

Një kooperativist: — E, shoku përgjegjës, t'u mbush mendja? Gëzohemi shumë, që më në fund u bindët. Ne presim të na vijë ushqimi në brigadë dhe... Mos na sorollatni më. Kështu mendojmë ne.

Brigadieri: — E bëmë planin. Specializimi i prodhimit është kryesori. Kështu mendojmë ne.

Përgjegjësi i dëgjon të gjithë. Ai mendon... Po edhe të tjerët mendojnë... Ai është një. Të tjerët janë shumë. Ai ka vulën, por ata kanë gurin dhe arrën. Ata të vënë, ata të heqin.

Ai flet mendueshëm:

— Shoqe... Shokë... Ju e kuptoni... Unë kështu mendoj...

Po ata ia prenë shkurt:

— Këtu bëhet si mendojmë ne e jo si mendoj unë. Mos e harro këtë, shoku përgjegjës!

Dhe ai nuk e harroi.

Dhjetor 1971

OPERATIVI

Shoku Selim është me «përgjegjësi». Ai zë një vend drejtues në aparatën e pushtetit në rreth dhe si i tillë i duhet të bredhë poshtë e lart nëpër kooperativat bujqësore, «t'u japë zemër» kryetarëve të kooperativave, «t'u shtojë entuziazmin», «t'i vëjë në pozita më të fuqishme revolucionare», «t'u ngrejë në një shkallë më të lartë frymën e mobilizimit» dhe të marrë masat më urgjente për të zbatuar detyrat e planit. Siç shihet, ka shumë punë ai e, brenda ditës i duhet të dërsijë mjaft, në rast se nuk ia do zemra që të dalë në raport para eprorëve të tij e t'i kullojë djersa gjatë gjithë tragës së kurrizit.

«Dielli duket që në mëngjes», thotë një fjalë e urtë, dhe shoku Selim, që nuk e harron këtë por e ka bërë moto të veprimtarisë së tij jetësore, «punën e mbarë» që në mëngjes e nis. Sapo del në zyrë, fërkon duart, bën shkri-fjen e mëngjesit duke i ardhur dy-tri herë rrotull tavolinës, kërkon evidencën, së cilës i hedh një vështrim vetëtimthi, thërret shoferin dhe, pasi merr kontakt me shefat e tij eprorë, sipas planit, si era me shi niset me shërbim poshtë në bazë, për ndihmë e kontroll a për kontroll e ndihmë.

Vizitën e parë e bën në kooperativën bujqësore «Agi-mi». Rrugës e ngul vështrimin arave ku zbardhëllen pambuku, dhe në vend që të çelet siç janë çelur boçet, ngryset si vjeshta me shi e i kthehet shoferit, Mihallaqit, një babaxhan njeri:

— Hë, o Llaqkë. Ke parë kështu ti? Pambuku digjet arave, e ata digjen pas muhabeteve. Ah, ç'dembelë që janë!

— Ashtu vërtet, — ia pret instinktivisht Mihallaqi, me vështrimin të ngulur në xhadenë gjithë gropa, — dembelë të mëdhenj janë.

Automobili qëndron para zyrave të kooperativës. Shoku Selim zbret dhe përshëndetet me drejtuesit që dalin dhe e presin me përzemërsi. Shoku Selim shkrehet menjëherë, sapo vë këmbën në zyrë, ndërsa zëvendëskryetari i kooperativës, që vë re se ai hodhi këmbën e majtë e jo të djathtë, siç është mbarësia, murmurit:

«Tersllëk. Urdhëro e prit tani!...»

Dhe dëgjon rrufetë e shokut Selim, që shkarkon me kërcëllimë të madhe.

— Turp! Turp ju them, dëgjoni? Do të mbajmë qëndrim! Mjaft kemi toleruar. O mblidhni pambukun sa më shpejt, o ejani vetë në komitetin ekzekutiv të rrethit! Qartë? Qartë thoni!

— Si urdhëron, shoku Selim! — Qe përgjigjja që mori atë çast.

Kjo e kënaqi. U ngrit.

— Bukur. Do ta shohim. Hajdeni, forca!

— Si urdhëron, shoku Selim! — Qe përsëri përgjigjja që priti.

Vuri këmbën në makinë, u ul në sedile, mbylli derën dhe nxori kryet.

— Dëgjuat? — ngulmoi. — Forca, ju them! Hajde jepini!

— Si urdhëron, shoku Selim!

— Mirë u pafshim!

Makina merr udhën përsëri duke u drejtuar kësaj rade dhe nga ana e kooperativës bujqësore «Përparimi». Përsëri shoku Selim vrenjtet si qielli me re të rënduara dhe turfullon:

— E sheh, o Llaqkë? E shoh thuaj. U lodhëm së dhëni këshilla, e këta as që i varin vëth në vesh fare, po nga njëri vesh u hyjnë e nga tjetri u dalin. Tokën e kanë pluguar, po u mbushet mendja të mbjellin? Jo, more! Në të tyren që në të tyren!

Hedh përsëri vështrimin ugareve dhe befaf thërret:

— Ja ku qenka. Mbaje, o Llaqkë dhe, pa lëvizur nga sedilja, thërret: — Pa hajde, pa hajde, o shoku kryetar! Hajde, se na e çuat buzën prapa veshit!

Kryetari i kooperativës bujqësore «Përparimi», një djalë i ri, energjik, afrohet me nxitim:

— Urdhëroni, urdhëroni, shoku Selim. Sot fillojmë mbjelljen e grurit.

— Ashtu?

— Po.

— E pse nuk filluat më parë?

— Tani na duket afati më i përshtatshëm.

Shoku Selim rrudh buzët dhe flet serbes-serbes:

— Shoku kryetar, tjetërherë duhet të zbatoni menjëherë dhe pa asnjë hezitim orientimet e dhëna!

— Më falni, po... Eksperimentimi shkencor..., — deshi të shfajësohej kryetari, po shoku Selim e ndërpreu:

— Eksperimentimi shkencor nuk duhet të vijë në kundërshtim me orientimet e dhëna. Qartë? Qartë thuaj. Po, meqenëse paskeni filluar sot, gjëne shyqyr. Hajde, jepini forca! Gruri është buka e popullit dhe me këtë nuk bëhet shaka. Qartë? Qartë thuaj. Punë e mbarë dhe faqe të bardhë!

— Të falemi nderit, shoku Selim!

Makina mori udhën. Shoku Selim iu drejtua shoferit:

— Drejt e në «Fitorja», Llaqkë! Ata qerratenj janë dehur nga fitorja dhe nuk po arrijnë në fitore. Po e lënë misrin pa korrur. «Si kështu, more? — nisi të fliste me

vete. — Kush ju lejon ju të talleni me bukën e popullit? Jo, shokë. Kjo është e pafalshme!»

Arritën. Shoku Selim zbret dhe me hap të shpejtë drejtohet te zyrat. Atje ishte vetëm shefi i llogarisë.

— Kryetari është arave, — i tha, — atje është edhe agronomi.

— Mirë kanë bërë, — dhe shoku Selim filloi të jepte urdhra dhe udhëzime. — Thuaj të korrin shpejt, se i thonë bukë, qartë? Qartë thuaj. Mos të bëjnë shaka me misrin! Të më njoftojnë sa më shpejt me telefon dhe me evidencë të rregullt! Qartë? Qartë thuaj. Hajde, të fala u bëj të gjithëve!

Dhe largohet. Dielli do edhe dy hostenë të fundoset përtej detit. Edhe shoku Selim merr udhën e kthimit për në zyrë. I kthehet Mihallaqit:

— U lodhëm, o Llaqë, u rropatëm gjithë ditën. Nuk patëm nge të hanim as bukë, djalli ta marrë! Nejse, mend për nesër. Mbase do të gjejmë ndonjë shalqi. Kështu ndodh kur njeriu harrohet pas punës.

Dhe shton:

— Epo duhet punë, o Llaqë. Jemi njerëz të punës ne, apo jo?

— Si urdhëron, shoku Selim, — ia bën Llaqka.

Makina qëndron para zyrës. Shoku Selim zbret. Një vartës e pret te praku:

— Të gjithë janë mbledhur e po ju presin, shoku Selim. A do ta zhvillojmë sot bisedën mbi luftën kundër rutinës dhe për zgjidhjen e problemeve në perspektivë?

— Bisedën? Posi. Ja, menjëherë.

Dhe shoku Selim futet në sallë, ku e presin. Pas një çasti ai filloi t'u fliste dëgjuesve se si çdo punonjës me punën e tij duhet të mendojë thellë, të ngrejë e të zgjidhë probleme të perspektivës e mos të përfshihet nga rutina,

që i sjell dëme të shumta dhe e burokratizon njeriun. Ai e vuri theksin mbi operativitetin.

Kështu, shoku Selim ka ç'të flasë. Përvoja e tij në këtë drejtim është e pasur.

Dy, që ishin andej nga fundi i sallës, i pëshpëritën njëri-tjetrit.

— Ka lezet kur flet kështu «operativi» ynë. Vetë merret me ickla e mickla, ndërsa të tjerëve u sugjeron perspektivën.

Ndërkohë, dikush trokiti dhe hyri pak si i druajtur.

— Më falni... — pyeti. — Këtu është shoku Selim? Selimi ia pat që nga tavolina e kreit.

— Hë, ç'është?

— Kanë ardhur ca njoftime... Ata të «Agimit» kërkojnë farë gruri. Të «Përparimit» kërkojnë pleh kimik, ndërsa ata të «Fitores» kërkojnë makina për transportimin e misrit.

Shoku Selim përplasi grushtin.

— Po atje isha, more. Po si nuk më thanë asnjë fjalë për këto probleme, të uruarit. Apo jo, more Llaqkë?

Llaqka, shoferi, që ishte futur edhe ai në mbledhje për të mësuar se «ç'është perspektiva», ndërhyri shtruar-shtruar:

— Epo... ishim, ishim, ashtu siç thoni ju, shoku Selim, ishim, po ata nuk patën nge as të na shihnin, e le pastaj të na flitnin.

Të tjerët nuk e përmbajtën dot të qeshurën, ndërsa Selimi, si për t'i dhënë zemër vetes, u përgjigj:

— Nejse, nejse... Njoftoni se do të shkoj vetë tek ata. Ja, kështu, shokë. Me kaq mbledhja mbyllet.

Tetor 1970

«BERBERI»

Ndoshta dikush do të çuditet që erdhi dita të flasim sërishmi për xherahët, të cilët janë zhdukur nga skena e teatrit të jetës; po kjo çudi e tij mbetet e pabazuar për faktin se, përderisa ekziston ligji objektiv i zhvillimit dhe i transformimeve, ekziston edhe mundësia që xherahu të gjendet aty-këtu midis nesh, po jo më si dikur, me brisqet varur në brez e me pincat në duar, gati për «operation». Jo. Në qoftë se ai do të kërkohet në atë terren, me siguri nuk do të gjendet kurrë. Xherahu ka ndryshuar pamje, është moderuar, është bërë njeri «modern», e askush nuk guxon t'i thotë «xhahil». Ai është veshur me një bluzë të bardhë si bora majë Macukullit, punon si berber i dalluar, merr pjesë thujse në të gjitha mbledhjet e kolektivit saherë që diskutohet për ndërgjegjen dhe është ndër të parët, në mbledhjen e lagjes, që ngrihet e «demaskon» fanatizmin dhe fanatikët, zakonet prapanike dhe njerëzit e molepsur me to. Ai hiqet si përkrahës i flaktë i së resë përparimtare, si revolucionar në mendime.

Hamiti, që ta merrni vesh ju të gjithë, ka parimet e veta në jetë. Sigurisht, nuk pretendohet që të ketë lexuar Makiavelin, po parimin makiavelian e ka përvetësuar si një artist i madh.

«Puna është të fitoj lekë, — mendon, — pa, si e qysh i fitokam, kjo s'ka rëndësi. E rëndësishme është që të rëndohen xhepat e mi».

Dhe, i udhëhequr nga ky parim, me pamje të ndry-

shuar, ai i hipi pelës e u nis për haxhillëk. Kësaj radhe si «Mekë» zgjodhi fshatin Cukan, vendin ku thonë se «lufta kundra zakoneve prapanike dhe bestytnive fetare ka arritur fazat më të larta».

Gjatë udhëtimit për në Mekën e shenjtë, (më falni, për në Cukan, desha të thosha) ai mendonte: «Thonë se në Cukan fanatikët u bindën dhe hoqën dorë nga zakonet prapanike. Kjo është shumë e mirë. Kjo është njëlloj sikur të ma kesh shtruar këtë udhë me sixhade. Askujt nuk ka për t'i shkuar mendja se unë po shkoj atje për synetllëqe. Pastaj... — Dhe këtu qeshi me vete. — Edhe në u shkoftë, ç'do të bëjnë? Një vrimë në ujë do të bëjnë. A tregon buza për hundën? Kurrë!» dhe, si për t'i vënë kapak mendimit, murmuriti i vendosur: «Përpara. Cukanit i thonë Cukan dhe cukanasit nuk e presin mikun në besë. Asgjë nuk ka për të ndodhur. Shko, sakato, bëj kërدينë, mbush xhepat me lekë dhe hejbet me peshqeshe dhe kthehu përsëri në gjirin e kolektivit tënd e aty, në mbledhjen më të parë, fol me pasion për shfrytëzimin e kohës së punës, ndërsa në mbledhjen e lagjes mba një fjalim të gjatë me titull: «Si duhet ta zbulojmë dhe ta godasim të vjetrën reaksionare, që është veshur me petkun e ri dhe paraqitet si e re përparimtare».

Kështu, me këto mendime në tru, ai e shpejtoi hapin dhe hyri në Cukan më të hyrë të diellit.


Lajmi u përhap vesh më vesh me shpejtësi rrufeje:

— Erdhi berberi. Erdhi berberi! Bëhuni hazër të gjithë!

— Pa zhurmë, pa zhurmë e bujë! Zhurma dhe buja i përkasin së kaluarës. Tani duhet të na karakterizojë thjeshtësia. Urtë e butë e plot xhepin, më falni, tiganin desha të thosha.

— Ashtu, ashtu, të keqen e dorës!

— Të briskut, thuaj!



— Njëlloj është. Ç'bëri brisku e ç'bëri dora. Që të dy një kokë i urdhëron.

Pregatitjet u bënë në fshehtësinë më të madhe. Më vonë disa erdhën dhe e pyetën:

— Gati jeni?

— Gati.

U ngrit, përveshi llërët, mprehu hanxharët, (brisqet desha të thosha), mori pincat dhe, sikur të ishte në kasaphanë (më falni, në berberhanë, desha të thosha) thirri me sa zë pat:

— Radhën!

Po askush nuk u ngrit. Siç duket, kësaj radhe i erdhi radha atij vetë që të priste radhën.

Korrik 1969

GRUAJA JOTE, THE?

Qëndronin të dy pranë banakut dhe pinin. Ishte mëngjes dhe ata i kishin përcjellë lëfytit nga dy ponça portokalli dhe dy gota verë. Kishin marrë gotën e tretë dhe lëpinin me majë të gjuhës nga një bisht peshku të tiganisur. Cilitdo që hynte e dilte në lokal i hidhnin nga një vështrim që nga koka e gjer te këmbët si për ta peshuar dhe nisin si motor i prishur:

— Erdhi edhe sevdalliu. I lumtë, kur i shkon gjemia!

— E ka rregulluar me atë, — ia ktheu tjetri. — Me të, more, he, me Kulumbri. Kulumbri i thonë dhe Kulumbri është. I vështrova mbrëmë se si i buzëqeshnin njëri-tjetrit.

— Një ditë unë e kam parë tek i shtrëngonte dorën një tjetre. Dhe çfarë të shtrënguari, se!

— Po, po, me siguri e kanë rregulluar. E shoh unë. Bic erë bisht langoi këtu.

Në lokal hyri një burrë dhe një grua. Ata i vështrojnë të porsaardhurit dhe qëllojnë njëri-tjetrin me bërryl.

— Pa shiko, pa shiko, na erdhi Miti. Çfarë do ta ketë atë grua? Hë, hë...

— S'ka veç dy javë që ka ardhur këtu me punë si teknik dhe shih: E rregulloi qerratai!

— Cila do të jetë vallë?

— Nuk e di. Mall i panjohur. Sot paska zbritur, o me parashutë, o ka dalë me maune.

Dhe nisën të çakarritnin sytë e të hargaliseshin me zë të çjerrë.

Ai, që u quajt prej tyre Miti, u shkoi pranë. Njëri nga të dy, ai pak më i moçmi, me trup pak të përkulur, me fytyrë të buhavitur, me ca sy të shpëlarë, e kapi prej krahu, e tërhoqi pranë vetes dhe i foli me ngërdheshje:

— Cila është ajo? Nga e paske psonisur?

— Është një shoqe nga qendra, — u përgjigj Miti buzagaz.

— Një shoqe nga qendra, ë... Hë, më ta marrsha të shoqes! Ku e zuri nata mbrëmë?

— Në hotel.

— Heu!

I buhavituri picërroi sytë, që dukeshin sikur i lëshonin shkëndija, u zgërdhi i tëri dhe vazhdoi tërë djallëzi:

— More, Miti! A mund të na prazantosh me të?

Miti e vështroi ngultas dhe pastaj i tha:

— Ejani, po të doni, t'ju njoh me të!

— Ë?!

— Po. Ejani t'ju njoh! Do të bëjmë edhe muhabet.


— Mirë. Erdhëm, — thanë të dy njëzëri.

Dhe Miti bëri përpara, porositi diçka te kamerierja dhe u kthye në tavolinën ku e priste ajo shoqja, një grua rreth të tridhjetave. I buhavituri, si kapërceu edhe gllënkën e fundit të verës, u tund e u shkund pak, rregulloi jakën e xhaketës dhe të dy u drejtuan te tavolina ku qe ulur Miti. Ai u ngrit dhe foli me njerëzillëk, sikur t'i shihte për herë të parë:

— A, a... Urdhëroni, urdhëroni, shokë të dashur! Ulu-ni! Njihuni, ju lutem. — Dhe iu drejtua asaj shoqes: — Shokët janë... — dhe shqiptoi emrat e të dyve. Pastaj u kthye nga ata dhe shtoi: — Shoqja është gruaja ime.

— ?!

— Gruaja ime. Pse çuditëni? Ka ardhur të më shohë.



Do të qëndrojë këtu nja dy ditë e pastaj, si të kemi rregulluar shtëpinë, do të vijë të banojë këtu për ngaherë.

I buhavituri u përplas në karrige dhe zuri t'i merrej goja.

Gruaja... gruaja... gruaja jote, the? Ë? More... Po... si të them....

— S'ke ç'të thuash. Kur gjuha del para mendjes, me të vërtetë s'ke ç'thua. Në raste të tilla ajo duhet prerë.

— Na lejoni të shkojmë?

— Si të doni.

I buhavituri u ngrit, ktheu kurrizin dhe nisi të dilte nga lokali si ndonjë kalë i këputur. Kështu bëri edhe tjetri. Miti i përcolli me një shikim plot qortim. E shoqja, që nuk mori vesh asgjë nga kjo skenë, pyeti:

— Ç'patën ata? Pse s'qëndruan?

— Asgjë, — u përgjigj i qetë Miti. — Besoj se sot duhet të kenë marrë një mësim të mirë.

Gusht 1969

SI KAPOSHI MAJË KURJAKUT

Thonë se kaposhi, kur këndon majë kurjakut, mbyll sytë, shkrifet i tëri dhe përpiqet ta zgjatë zërin sa më shumë, në mënyrë që ta dëgjojnë të gjithë e të thonë: «Nefez të bukur paska.» Them thonë, sepse me të dëgjuar e kam. Ma ka thënë një trainer futbollit.

— E ku ka mend kaposhi që të mendojë kështu siç thua ti? — e kundërshtova, po treneri nuk u tërhoq asnjë çast nga mesi i fushës dhe unë, për të mos dalë «ofsajt», u detyrova të heshtja. Fundja, kam arsye të hesht para trenerit të nderuar. Ai di ç'thotë. Ai di ç'bën. Atë e dëgjojnë gjithë ata lojtarë dhe e nderojnë gjithë ata tifozë e jo më unë, që jam elifi matrak jo vetëm kur bëhet pazari i kaponjve, por edhe kur jepen gjykimet për futbollin, për skenat taktike, për teknikën, e ku di unë.

Siç duket, treneri duhet ta ketë yënë re kaposhin kur këndon majë kurjakut, pra dhe do të ketë arritur në atë konkluzion, sepse ndaj edhe ai ka filluar të shohë e të gjykojë që nga maja e kurjakut e me sy mbyllur si kaposhi.

Traineri ynë edhe mund të zemërohet që e kam krahasuar me kaposhin, po kjo është e vërtetë dhe e vërteta mund të mbulohet aq, sa mund të mbulohet edhe dielli me shoshë.

Kënga e trenerit tonë nis qëkur ai nis e jep variantin e lojës. (Nuk po e zë në gojë, sepse kjo puna e trenerit

dihet. Ai pretendon se në këtë sferë ngatërrohen të gjithë, kompetentë dhe jokompetentë dhe ai vetë mbetet si dashi i kopesë, që ia kanë varur këmborën në qafë e nuk e lënë ta tundë. Kjo i jep mundësi që, për çdo rast që kritikohet ndërtimi i formacionit, të thotë: «S'kam faj unë. Nuk të lënë të tjerët»).

E pra, e kishim fjalën te varianti i lojës, sepse pikërisht këtu nuk e ngatërrohen kush. Mirëpo varianti ndërtohet në bazë të stërvitjes që kanë bërë lojtarët dhe vetë stërvitja lidhet ngushtë me njohuritë tekniko-taktike që u jepen lojtarëve teorikisht dhe praktikisht. Këtë këngë treneri e di mirë, madje e di edhe me nota dhe është gati ta këndojë i shoqëruar me çfarëdolloj instrumenti.

Unë e kam dëgjuar atë të këndojë saherë që skuadra ka luajtur dhe ka fituar. Në të tilla raste ai ka dalë nga rrethi i ngushtë, ka dhënë edhe intervista dhe ka ngritur zërin e tij gjer në kupë të qiellit: «Lojtëm mirë, ndaj edhe fituam, se fitoren, vëllezër e motra, nuk ta fal kush për mëshirë. E qarkosëm kundërshtarin si në një darë të hekurt e të përskuqur dhe e detyruam të dorëzohej. Sulmi ynë ishte një uragan i papërmbajtur. Mbrojtja jonë u bë bllok graniti e pakalueshme në asnjë rast. Kjo i dedikohet lojës plot fantazi të njëmbëdhjetëshit tonë dhe burimi qëndron në përgatitjen e gjithanshme tekniko-taktike në bazë të varianteve të dhëna, variante këto që ishin hartuar me kujdes, duke marrë parasysh aftësitë e skuadrës sonë dhe të kundërshtarëve.» (Këtu ai nuk thotë vetëm këtë: «E gjithë kjo fitore më dedikohet mua sepse, në fund të fundit, unë isha dhe jam ai që e stërvit skuadrën»). Këtë nuk e thotë jo për thjeshtësi, po sepse mendon që kaq gjë secili duhet ta marrë me mend vetë.

Kaq për fitoren.

Po kur mundemi?

Këtu ndryshon fjala. Traineri ynë qëndron përsëri

si kaposhi mbi kurjak e me sy mbyllur zë e këndon një këngë vaji, që e ka mësuar ta këndojë përmendsh, sa herë «që t'ia lypë nevoja dhe kur t'ia lypë nevoja»: «E ç'të them, more shokë? Ç'të them?» — Zëri zë i dridhet e i përdridhet si tel i çakorduar. «Na ra shorti i keq. (Ah, ky qerrata short i keq! Ka filluar të futet kudo si xhol.) Ke parë kështu ti? Nuk na do shansi.» Mos ia merrni për fanatizmë. Siç duket, kur u hiqkan shortet, «fatet» e skuadrave u varkan në ato copëza letre e jo në aftësitë e secilës skuadër).

Dhe vazhdon:

— Apo nuk u dërmuan nga udhëtimi. Kur shkuaam atje, ishim bërë si kuaj të këputur. Lëre pastaj që e zhvilluam lojën në terren të rëndë. Tersllëqe, më besoni! Tersllëqet e gjithë botës na u mblodhën, po s'mjaftuan gjithë këto, kur na edhe arbitri! U shqye së mbajturi me hatër dhe e bëri që e bëri të tijën. S'ke ç'i bën.

Dhe, si heq një psherëtimë të thellë që të këput shpirtin, përfundon me gjysmë zëri: «Shyqyr që shpëtuaam me kaq, se ka edhe më keq.»

Dhe, si ul krahët (më falni, e kisha mendjen te duart, me lëvizjet e të cilave shoqëron argumentimet e tij «shken-core»), mbështet kryet e perëndon sytë i pikëlluar.

— Nuk na ecën, vëlla, jo, nuk na ecën. Dhe zëri i meket fare.

— Ama të bukur avaz që na zë, o trainer! Si të bjerë daullja, vete e ma hedh këmbën. Kur fiton skuadra: «Rroftë trainerin!» Kur humbet skuadra: «Më qafë na paçin kusuret!»

— Kur do të mbarojë kjo kënga e trainerit tonë, që i ngjan këngës së kaposhit, që këndon me sy mbyllur majë kurjakut?

— A do t'i hapen sytë trainerit tonë të shohë reali-

tetin dhe t'i përvishet punës për ta çuar futbollin tonë më përpara?

Një që e dëgjoi pyetjen e bërë nga një grup tifozësh, ua priti aty për aty:

— Po, po de, se do të zbresë nga kurjaku.

Prill 1968

NOVATORI ME TAKIJE...

Unë u bëra «heroi» i novatorëve dhe kjo për shkak të gruas, kryetarit të kooperativës, të atij shokut që merrej me përgatitjen e mbledhjes së novatorëve e racionalizatorëve dhe takijes sime të bardhë borë, si takija e baba Tomorrit.

Atë ditë, gruaja m'u vardis e m'u bë rrodhe.

— O të vesh sot në qytet e të blesh një kuvertë nga ato të kombinatit «Mao Ce-Dun», o bjer e vdis, — thosh-te. — E dua, që e dua. As unë jam më e keqe se shoqet dhe as konaku ynë mbetet më pas të tjerëve. Krevati pa atë kuvertë sipër duket si pa gjë, tamam si kaposh pa bisht.

Unë zieja përbrenda. I erdhi goja edhe sime shoqeje, pa le të tjerave.

— Po ty të kanë rënë brinjët në rrogoz, moj lumëmadhe, — i thashë duke u përmbajtur. — Tani dole në breg e kërkon ta mbash bishtin cakërr. Po nuk i hodhe kuvertë krevatit, na u prishka bota, nuk e sheh! Nuk thua që erdhi edhe për ne dita të blejmë krevat, po dashke edhe thelë mbi bisht!

— Dua.

— Gjeje atëherë, — iu shkruhe.

— Sillma! — nuk u përmbajt as ajo. — Lekët i kam nga krahët e mi e nuk po t'i kërkoj ty. Veç ti të më gjesh një kuvertë e të ma sjellësh në shtëpi, se unë nuk të ndahem.

Rrodhe, beson? Rrodhe më është bërë tërë jetën dhe tani, sa vjen e lashtohet, më tepër më ngjitet e s'më lë rehat. Se ç'i vete e i shkrepet në mendje dhe fap, unë që unë e pësoj. Kështu ma bëri edhe aty tani, pasi morëm radion. «Duam një bufe, — më tha. — S'ka lezet shtëpia më me radio e me koçek. Na duhet pa tjetër një bufe.» — Dhe plasi gjersa e blemë. Ja, edhe tani kështu ka zënë.

— Po prit, — i thashë, — prit. Do të dalin në dyqanin e fshatit tonë dhe e blejmë.

Asaj i shkëlqyen sytë.

— E gjete. Të mbetem e fundit, ë? Bukur më mëson, — dhe u ngrit. — Na, — më tha dhe më vuri në dorë lekët. — Na, vër opingat në këmbë dhe nis! Nisu, se, për kokën e çunave, do të të ha me lëngje, sa të jesh gjallë!

E pashë ngushtë dhe u ngrita. Fundja, ka të drejtë e uruara. Jemi bërë me shtëpi të re. Edhe të ardhura kemi, se ne punojmë në kooperativë dhe nuk bëjmë shaka. E pse, fundja, se mos jemi më pas nga fqinjët, që kanë blerë të tilla kuverta?

Kështu, gruaja ma mbushi mendjen dhe unë, si u rrova e u vesha për bukuri, u nisa për në qytet. Kur dola në qendër të fshatit, më takoi kryetari i kooperativës.

— Për ku kështu, o Tasi? — më pyeti.

— Në qytet, — i thashë.

— Në qytet? — kryetari m'u afrua tërë qejf. — Po ti fol, o Tas xhani, se më shpëtove, — më tha. — Meqë po vete në qytet, kthehu njëherë andej nga komiteti. Më kanë thirrur në një mbledhje po për ç'beson, tërë këtë javë u gdhiva e u ngrysa nëpër mbledhje. Ç'bëre ti e ç'bëra unë. Fundja ti anëtar kryesie je dhe, për atë problem që diskutohet, ti je i ngarkuar nga kryesia.

Të them të drejtën, më erdhi mirë që më ra radha edhe mua të veja njëherë në një mbledhje, se vërtet më

kanë zgjedhur në kryesi, më kanë caktuar edhe me ndjekjen e disa problemeve, po vetëm sa më kanë caktuar ama se, për sytë e ballit, as që pyet njeri për mua. Të gjithë pyesin kryetarin dhe kryetari flet për të gjithë.

— Po si, o kryetar, — i thashë, — të vete unë në mbledhje, the?

— Dhe të mbash shënime, — ma ktheu kryetari. — E, ç'shënime të mbash, të na i thuash shkoqur një e për një.

— Si kokrra qiqre, ore, — ia prita. — Mos u bëj merak ti. E rregullon Tasi këtë punë.

Kryetari sa s'më puthi, që shpëtoi nga telashi i asaj mbledhjeje dhe unë, i ngarkuari për të blerë kuvertë krevasi dhe i autorizuari për të marrë pjesë në një mbledhje shumë të rëndësishme, u nisa për udhë.

Pas një ore u gjenda në qytet dhe, ashtu siç e do zakoni, e mbajta frymën në një kafene.

«Një kafe pas udhës, thashë, të zë lukthin e të gjen zemrën. U bëftë ç'është për t'u bërë, po as kuverta merr vrapin nga dyqani dhe as mbledhja sos pa u nisur. Po kur ke pirë një kafe, sikur di ç'flet, se i thonë kafe asaj: e zezë vërtet, po ië zbardh mendjen, t'i mbledh dhinë.»

Dhe u ula, porosita dhe nisa të rrufitja ngadalë kafënë që më solli kamarierja. E ndeza edhe një cigare duhan, se ajo e shkretë kafe me duhan e ka lezetin e saj.

Rrija aty në kafene dhe mendohesha. «Mirë kuvertën se do ta blej, po në mbledhje ç'do të them?» Më erdhi inat që nuk e pyeta kryetarin, po punë që shkoj ajo. Ora po afrohej dhe unë, si pagova, u ngrita. Kur dola te dera, një shok më kapi prej krahu. E njoha. Ishte një nga punonjësit e bashkimeve profesionale të rrethit. Kish-te ardhur njëherë si i deleguar në fshatin tonë.

— Po ku je, o Tasi, — më tha, — po hë, o i bekuar, se u bë vonë. Shpejt, shpejt, se po fillon mbledhja!

— Cila mbledhje? — e pyeta.

Ai ma preu shkurt.

— Mbledhja, more, mbledhja e novatorëve dhe e racionalizatorëve.



— Novatorëve? E ç'janë këta novatorë? Mua kryetari më tha vërtet të vete në një mbledhje, po ajo është për tjetër punë.

Shoku nuk ma lëshonte krahun dhe më tërhiqte osh.

— Mbledhje është, o Tas vëllai, mbledhje është. Ç'bëri këtu e ç'bëri atje. Njëlloj është. Njëlloj e mbush kokën. Fundja, hyr njëherë këtu e pastaj me të parë e me të bërë. Kur të dalësh që këtej, shko edhe andej. Ja, ulu këtu dhe hesht, për kokën tënde, se nuk e sheh që zuri vend presidiumi i mbledhjes?

Duke folur, ai më kishte futur në sallën e mbushur plot e përplot me njerëz. Unë u gjenda i ulur në një stol dhe fillova të duartrokita si gjithë të tjerët.

Pastaj e mori fjalën një nga ata të presidiumit.

— Ju jeni racionalizatorë të dalluar, — filloi të thoshte, — keni bërë shpikje të shumta, po mos t'ju rritet mendja! Ja, ai shoku atje, me atë takijen e bardhë, kushedi sa shpikje ka bërë, që shokët e kanë dërguar si përfaqësues të tyre në këtë mbledhje, po nuk besoj të jetë bërë mendjemadh, apo jo?

Të gjithë i drejtuan sytë nga unë. Nuk po merrja vesh asgjë. U ngrita.

— Me mua e ke? — i thashë.

— Po, po, me ty. Nuk je ti shpikës e racionalizator? — pyeti. — Je, — u përgjigj po vetë dhe vazhdoi. — E pra, nuk duhet të të rritet mendja, or shok. Ti je edhe i moshuar ca dhe e kupton fort mirë se ç'do të thotë të të rritet mendja, sepse populli ka thënë që «mendja e madhe është e zeza e të zot.» Është nder i madh pra të jesh shpikës. Është nder i madh gjithashtu të marrësh pjesë edhe në këte konferencë, po kjo nuk duhet të na dehë.

Unë ngela i hutuar si kaposhi i detit. Më kujtohej se njëherë pata ndrequr veshët e parmendës po kishte

lashti shumë që kishte ndodhur, e fundja nuk ishte ndonjë gjë për të qenë. Vërtet parmendat unë i kam ndrequr në fshat. Bile edhe atë hinkën për të hedhur pleh në grykën e plugut unë e bëra, po sa para bën. Pse, për atë e kishte fjalën ai?

E humba.

— Ore vëlla, — i thashë. — Unë jam Tasi. Jam nga filan kooperativë. Më njeh ti, a s'më njeh? Ai shoku që më solli këtu më njeh. Unë dorakë parmende kam gdhendur tërë jetën, po mendjen në vend e kam dhe nuk e kam nxjerrë kurrë majë takijes. Më tej nuk merr vesh xhaxhai.

Salla ia plasi gazit. Edhe ai shoku i presidiumit qesh-te. Qeshja edhe unë.

— Po pse ke ardhur, o Tasi? — më pyeti ai. — Përse ke ardhur në këtë mbledhje?

— Ku ta di unë, — ia pata duke mbledhur supet. — Më prunë, erdha. Më lënë, iki.

Përsëri ia dhanë gazit. Dikush tha me qesëndi:

— Ik, o Tasi, ik. Ik në punën tënde, se nuk bëhen mbledhjet kështu, gjej njerëz rrugës dhe fut brenda në sallë, sa për t'u dukur se gjithçka është në rregull. Kësaj i thonë të ngopesh me lugë të zbrazët. Ik, o Tasi, ik e mbaro punë për ku të kanë nisur.

Unë dola jashtë duke mallëkuar gruan që iu kuturis mendja për atë djall kuvertë, kryetarin që u kujtua për mua të më çonte në një mbledhje, pa më thënë për se, atë shokun që më futi në mbledhjen e novatorëve sa për të mbushur sallën dhe takijen time të bardhë që dallonte majë kokës, e që unë harrova ta hiqja kur hyra brenda në atë sallë. Fundja, po të mos qe takija, asnjëri nuk do të qe kujtuar për mua në gjithë atë sallë mbushur deng.

— Ama edhe ti, — më tha ai shoku që më futi brenda, — na nderove.

Unë çakarrita sytë.

— Më nderove, të nderova, — i thashë, dhe ika. Kur shkova në dyqan, e gjeta mbyllur. Edhe mbledhja ku do të shkoja si përfaqësues i kryetarit tonë të nderuar kishte marrë fund. Kështu u ktheva në fshat, po veç u ktheva «novator»!

Janar 1971

KËTU JAM ZOT UNË...

(Monologu i një kryetari kooperative)

— Unë quhem... E ç'rëndësi ka kjo për ju? Fundja edhe unë kam një emër të rëndomtë, si gjithë të tjerët. Dhe e rëndomta për ju nuk paraqit asnjë interes. Ajo që ka rëndësi, është se unë jam kryetar në një kooperative bujqësore dhe, si i tillë, duhet të njihem nga të gjithë.

Dhe, që ta merrni vesh ju, kjo e «veçanta» ime nuk qëndron «havadan», për shkak se unë kam kokën time.

Të gjithë kanë kokë, nuk e mohoj këtë, po si kokën time, që pjell aq shumë, më shumë se ç'pjell vezë pula e zezë e komshiut, rrallë gjen. Kjo, në fund të fundit, ka të bëjë me karakterin. Unë jam intrasigjent. Fjala intrasigjent, që ta merrni vesh ju, e shqipëruar mirë e mirë, do të thotë: «Këtu, ku urdhëroj unë, bëhet vetëm si them unë. Të tjerët le t'i rrahin këmborët, se mua zilka më duken. Po jua shkoqit edhe më mirë.»

Më vjen, që thoni ju, një urdhër, ta zëmë nga komiteti ekzekutiv i k p të rrethit, domosdo nga seksioni i bujqësisë e kam fjalën, dhe më thotë: 85 për qind e kraheve të punës të hidhen në frontin e mbjelljeve sepse jemi prapa. «Posi! Këtë e di unë. Jam unë bari në këtë stan. Mbjelljet presin edhe ca. Ka valik. Kam halle të tjera që nuk presin.»

Po do të thoni ju: «Pse nuk e kundërshtuat në aktiv, hë?» Pse, budalla jam unë! Nuk e ha lala atë kokërr

ulliri! Po të kundërshtoja në aktiv, do të çoheshin të gjithë për të më kritikuar, kurse kështu si e kam zënë unë, i thonë: urtë e butë e plot tiganin. Ata në seksionin e bujqësisë të rrethit le të çirren sa të duan, ndërsa unë vazhdoj të mbaj drekun tim.

— Si, si? Kemi centralizim, — tha dikush.

— Pusho, more! Atë e di unë. Pastaj kjo, more vëllezër, ka edhe një burim tjetër. Unë nuk jam servil. Ja që jam i tillë. Ç't'i bësh? Më pëlqen më mirë të rri drejt si shkop thane. Kështu e shoh edhe më mirë dynjanë. Kjo shpjegohet edhe kështu: Para ca ditësh më njoftuan me fonogram: «Përdorni metodën zinxhir në plugimet dhe mbjelljet. Bëni diskime dhe lesime, që të mos humbitni vlagën. Përdorni sa më shumë plehurat organike».

Aty le të mbahen. Le të dërgojnë fonograme sa të duan. Kur nuk u vjen keq për lekët e shtetit, le të mbushin letra me të shkruara e ku di unë. Se punoj me metodën zinxhir a me metodën tërkuzë, këtë e di unë. Vlagë e pa vlagë edhe këtë e di unë. Na e bënë këtë të shkretë vlagë si pikëz vese. Le pastaj me atë plehun! Aty u mbeti mendja dhe nuk shkulen. Sikur pa pleh organik nuk u bëka gjë. Po plehun kimik pse e kemi atëherë? Të rrojë plehu kimik, vëllezër! Unë kështu e kam zgjidhur këtë problem. Thoni si të doni, po mendjen e kam xhevahir.

Pse nuk i thashë këto në mbledhjen e këshillit popullor? Ah, jo. Janë çështje të brendshme. Pastaj, mos harroni edhe parimin, ju lutem. E thashë edhe më lart. Nuk jam servil. Po të jetë se do të zbatohet urdhrat nga lart, të gjithë do të ngrihen e do të thonë: «Ia mblodhën qerratit dhe u tulat si lepuri në strofkull!»

Kush u tulat, more, unë? Unë luani i maleve? Asnjëherë! Asnjë urdhër nga lart të mos zbatohet! Kështu urdhëroj unë, kryetari! Jam unë zot konaku këtu! E qartë?

Çfarë? Erdhi fonogram? Pa lexoje! Si, si? Të para-

qitem në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit? Jam në raport? Hëm! Bela e re, more vëllezër. Duhet të përgatitem për ca minuta «autokritikë». Pastaj e di vetë unë... Sa të hedh lumin, pa!...

Po kësaj radhe lumi i asamblesë së kooperativës ishte aq i gjerë dhe i thellë, sa që ish-kryetari nuk gjeti dot va për ta hedhur, prandaj i ra me not dhe doli në breg... i lagur...

Nëntor 1970

LEGJENDA E DERRAVE

Kur ngjarjet nuk shkruhen nga historianët, ato kalojnë gojë më gojë, nga njëri te tjetri e kështu kthehen në legjenda që shpeshherë nisin kështu:

«...Tregojnë se njëherë moti...», dhe zënë e të shkoqitin fill e për pe se si ndodhi e tek ndodhi me këtë apo me atë, ta zëmë, se si u lanetosën derrat në fshatin tonë.

Dikush mund të thotë:

— Edhe derrat do na u futkan në histori?

Eh, more vëlla i dashur. Derrat e fshatit tonë kanë një histori të gjatë e kjo, ngaqë nuk u shkrua, mbeti si legjendë e nami i saj i kaloi kufijtë e rrethit.

Dhe kjo legjendë nis e përfundon në disa variante.

...Thonë se derrat e fshatit tonë ishin nga më të shëndoshët në gjithë rrethin. Kështu nis varianti i parë, po ja që erdhi një ditë e ata i zhdukën nga fshati. Kjo ndodhi për hesap të një harçi. Që thoni ju, tregojnë se një harç i shëndoshë, që e kalonte kuintalin, na u tërbua e na u turr me yrysh andej nga çesma, kur gratë po mbushnin bucelat me ujë. Dhe na kafshoi harçi i tërbuar një grua e t'u bë bujë e madhe në fshat aq, sa u ngritën të mëdhenj e të vegjël e na e vranë harçin me sfulqje e me sëpata. Pastaj kuvenduan mbarë e prapë e i dhanë karar që derrat t'i shitnin. Dhe ashtu u bë. Që nga ajo ditë gratë shkojnë në çesmë pa merak për të mbushur ujë.

Varianti i dytë u nis tjetërsoj.

...Derrat e fshatit tonë, po si derrat e fshatit tonë thuhaj. U bënte miu fole në tulet e nuk e ndienin. Po donin ushqim ama, dhe kooperativa nuk ua dilte mbanë me të ngrënë e me të pirë, ndaj dhe i shiti. Duan bazë të fortë ushqimore ata, ore!

Varianti i tretë e paraqit legjendën me nuanca romantike.


...Kur vinte vera, kooperativistët zbritnin arave përfund fshatit. Dielli i përvëlonte mbi krye e ata, të djersitur nga lodhja, i drejtoheshin vijës së ujit për të shtuar etjen. Pastaj, në pisk të vapës, ia shtronin gjumit hijeve e, kur vapa ngrihej, nisnin sërishmi punën bashkë me flladin e ëmbël. Po ja që një ditë derrat e mallëkuar na u futën në vijën e ujit në krye të fshatit dhe e llokoçitën atë me feçkat e tyre. Uji u ndy. Po të kishte qenë një herë hajde de, po ata vanë e na e bënë zakon këtë. Në fshat u dha beriha ja. U mblodhën kokë më kokë kryesia e kooperativës, e cila nxori një urdhër të prerë: «Derrat të mos shihen më në fshat!» Dhe ata nuk u panë që të nesërmen.

Varianti i katërt i bie më shkurt:

...Kishin ca derra që na hapën një mijë e një telashe e që disa nuk i shihnin dot me sy. Pastaj, kush e hante mishin e derrit! Larg qoftë! Edhe ajo na duhej. «Të prishim stomakun?!» Po hallit? Si me lezet u hap nami se rritja e derrit është antiekonomike dhe fët e fët një ditë, papritur e pa kujtuar, fshati ynë mbeti pa derra. Kooperativa «shpëtoi» nga telashi i tyre. Edhe fshati ra rehat.

Ja, kështu thonë legjendat.

Thonë se në kooperativën tonë bujqësore kanë pasur dhe kanë rritur derra. Kështu them edhe unë, po tani aty askush nuk thotë: Në kooperativë ka aq derra. Ata janë zhdukur pa lënë nam e nishan. Prej tyre ka mbetur vetëm kujtimi e kujtimi është kthyer në legjendë e legjen-



da tregohet saherë që i vjen sëra. Ata të kryesisë qeshin
e thonë:

— Ama, lëri e mos na i kujto të mallëkuarit. Shyqyr që shpëtuam, se kush merrej me ta!

Të shkretët derra! A thua e dinë gjëmën e madhe që u kanë punuar? Ku ta dish! Ndoshta për ta duhet të jetë mbajtur ndonjë procesverbal!

Mars 1968

GJUHË LLFAZANËSH

Me të vërtetë e çuditshme kjo gjuha e llafazanëve. Nuk pushon kurrë dhe gjithëherë, duke u dredhur e përdredhur si gjarpri nën gur, nuk e thotë dy herë të njëjtën fjalë.

Dhe kjo gjuha e llafazanëve ka disa kode të saj, me çelësat e të cilave ata zbërthejnë mendimet e njëri-tjetrit, i fryjnë e i fryjnë gjërat, paçka nëse më vonë, gjithë ai mal na pjell një mi ose na del shterpë fare.

Dhe njëri prej kodeve të gjuhës së llafazanëve (ai që më ra në dorë mua) ndahej në disa kapituj e çdo kapitull kishte fraza të përcaktuara qartë, të cilave llafazani u përmbahet me rreptësi.

Kapitulli i parë fillonte në brigadë. Ai niste kështu: Brigadieres së re, që posa është zgjedhur, foli me kapadaillek:

— Nuk më urdhëron dot mua. Unë jam burrë!

Në sytë e të tjerëve mundohu ta diskreditosh. Për këtë qëllim fol sa të mundësh vesh më vesh:

— Iu rrit mendja. Sikur nuk e njohim se cila është.

Kur e sheh ngushtë, çil kapitullin e dytë. Paragrafi i parë i këtij kapitulli sugjeron: Për të bërë presion, shkoi në shtëpi dhe ankohu te burri i saj:

— Or ti! Do të ma heqësh tèt shoqe qafet, apo jo? Më është qepur me bukë në trastë. Nuk i kam faj. E zëntë haka ime!

Ku ta dish? Ndoshta i shoqi lëshon pe dhe e urdhëron:

— Që nesër të hiqesh nga brigadierllëku. Nuk duroj fshatin në shpinë unë.

Ja që fitove. U fute zjarrin në shtëpi.

Po e pe se dhe kjo nuk të pi ujë, ktheje fletën dhe dil te kapitulli i tretë, që përmbledh artin e shpifjeve dhe thashethemeve.

Atëherë, me gjuhën e vogël filloja buzë më buzë e vesh më vesh:

— E patë brigadieren? U ngul si hu gardhi anës le-dhit me atë fqinjin e saj e nuk shkulej nga vendi. Pse? Ç'kishin vallë? Do të jenë yshtur. Me siguri kështu është.

Shpif dhe mblidhu si iriqi në gozhup të vet, se nuk të gjen gjë.

Një ditë tjetër:

— Po, po, po... Na turpëroi të gjallë e të vdekur kjo brigadierja jonë. Llap poshtë e përpjetë: — E pashë tek u pa sy ndër sy me atë çamarrokun. I dhanë edhe shënja njëri-tjetrit. Kushedi. Faqja e zezë i qoftë!...

Kapitullin e katërt përdore në rast rreziku. Aty përmbliidhen S.O.S. — e të shumta, që duhen lëshuar me urgjencë, posa që të fillojë mbledhja e organizatës së Frontit për të shkurtuar gjuhët llafazanc.

— Unë? E kenë gabim, more shokë. Brigadierja jonë është flori. Asaj nuk ia gjen shoqen. Unë ngaherë kam pasur respekt për të. Kudo kam thënë fjalët më të mira. Edhe kur u zgjodh, unë ngrita gishtin i pari e votova për të. Për kokë të çupës, më besoni!

Sa për njoftim: Ky kapitull është hartuar posaçërisht «Për të shpëtuar lëkurën».

Kapitulli i pestë nuk ishte caktuar në këtë kod dhe kjo, siç duket, për arsye se hartuesit e tij do të kenë paraparë mundësinë që mbledhja e Frontit t'ua priste gjuhën llafazanëve.

Shtator 1969

BRIGADA E TETË BRIGADIERËVE

Mund të themi me plot gojën se kemi rënë në hall të madh. Na kanë ngjitur nofkën: «Brigada e tetë brigadierëve». Kjo është e vërtetë. Qëkurse është formuar kooperativa e gjer më sot, pak a shumë tetë brigadierë na janë ndërruar. Sapo caktojnë një brigadier të ri, prite kur ta heqin.

Histori e dhimbshme kjo jona. Sipas statutit brigadierin duhet ta zgjedhim ne, anëtarët e brigadës, e ta aprovojë mbledhja e përgjithshme apo përfaqësia e kooperativës, po te ne çdo gjë e bën kryesia. Me sa duket, nuk do të na harxhojë kohën që të vendosim ne, se kush duhet të na drejtojë. Dhe historia e brigadierëve tanë nisi kështu:

I pari: U gëzuam shumë. Thonë se ishte brigadier i mirë, sepse ka qenë bujk i mirë. Kështu thonë, kështu themi edhe ne.

Pas një viti: Brigadierin na e hoqën. Caktuan një tjetër. Për të parin thonë: «I mirë, po e dorëzoi vetë, pasi ishte pak zaif.»

I dyti: Brigadieri i dytë e nisi punën me vrull. Kështu e kanë të gjithë ata që e marrin punën sërishmi. Do të sjellin nga një të re. Nuk e thonë kot: «Dhëndrri i ri do ta tregojë veten.» Kështu edhe brigadieri ynë. Na e mblodhi. More le neve, po ua mblodhi edhe atyre të kryesisë, që nuk ia varnin torbën brigadës sonë. «Mirëpo ata të kryesisë janë njerëz me sedër dhe nuk të lejojnë

t'u marrësh erzin.» Kështu që, pas një viti, na sollën një brigadier të ri. E hoqën atë që ishte pasi, siç thonë ata të kryesisë, «lëshoi deklaratë se nuk e kryente dot detyrën e brigadierit.»

I treti: Na caktuan një grua si brigadiere. «E dëgjuat? Te ne caktuan si brigadiere një grua. Domethënë këtej e tutje do të na komandojë një grua.» Ca nga ne i varën turinjtë. Edhe gojën e hapën. «Punë që s'bëhet. Çapi i saj nuk duhet të shkojë larg. Tani e pat brigada jonë. Punë grash kjo. Ju e kuptoni edhe vetë.»

Dhe shokët tanë të kryesisë, për të mos u prishur me këta njerëz, na e hoqën brigadieren. «Shyqyr që shpëtuam! — u gëzuan fanatikët, — shokët e kryesisë i kemi burra me mend...»

I katërti: U qamë nga shiu dhe ramë në breshër. Na hoqën një grua dhe na sollën një burrë. «Shokun nuk ia gjen për prapësira», ngulnin këmbë dembelët. Këta vërtet ishin dembelë, po veç fjala e tyre u ngjit me shkathësi gjer në kryesi. Dikush e shtroi problemin parimisht: «Ai brigadier, që nuk fiton dashurinë e të gjithë anëtarëve, nuk mund të drejtojë.» Dhe e hoqën. Me sa mora vesh, largimin e brigadierit e motivuan kështu: «Nuk gëzon besimin e brigadës.»

I pesti: Përsëri na caktuan një burrë. Me sa duket brigadieri i ri i ka vënë detyrë vetes ta nxjerrë brigadën nga prapambetja. Ne jemi solidarë me të. E përkrahim në çdo inisiativë të tij. Shqyrtojmë së bashku detyrat dhe nxjerrim dobësitë. Së bashku i bëmë vërejtjet edhe në adresë të drejtuesve të kooperativës. Kjo e shqetësoi kryesinë: «Po na bëhet kaposh ai kapedani.» Dhe pas një viti brigadierin na e hoqën. Kësaj radhe motivacioni që i dyfishtë. Një pjesë thoshte: «I mirë, i mirë, po nuk e bënte dot», kurse pjesa tjetër: «Mjaft më me burrat. Në krye të brigadës duhet vënë një grua.»

I gjashti: Dhe vunë një grua. Tani në brigadë ne kemi në krye një brigadiere e të gjithë betohen për kokën e saj. E duam dhe e respektojmë. Ajo dhe ne jemi një. Jemi shumë të gëzuar që edhe brigada jonë po futet në rrugë të mbarë.



Pas një viti: Brigadieren na e hoqën: «U largua vetë», thonë, po ne nuk e besojmë. Ne ngulim këmbë dhe themi se na e hoqën ngaqë brigadierja jonë kritikonte ashpër e nuk pajtohej me të metat e kryesisë.

I shtati: Përsëri në krye të brigadës kemi një grua. Kjo na gëzon pa masë, jo pse është grua, po sepse është një drejtuese e zonja. Me këtë brigadiere, me siguri, atë vit do të dilnim në krye. Por a e dini ç'ndodhi? Pa mbaruar mirë viti na e hoqën brigadieren. Pse? Dëgjoni: «Ajo sikur kakaris shumë në brigadë. Nuk është për brigadiere.» Kaq thanë dhe ja ku u gjendëm pa të.

I teti: Megjithkëtë, për të ruajtur «parimin», në krye të brigadës sonë vunë sërish një grua: Kjo është shumë e hedhur në punë. Edhe në aktivitetet shoqërore nuk ia gjen shoqen. Po ke parë kështu ti! Kanë filluar e hapin fjalë: «E ka mendjen për të bredhur, për të kërcyer. Pas punës, kërkoje ku janë këngët e vallet. Nuk drejtohet brigada kështu!»

Kaq thonë dhe ne na ka zënë lemza. Bathët nuk janë të mbara. A thua se brigada jonë e tetë brigadierëve do të provojë të nëntin? Ku ta dish! Gjithçka mund të ndodhë. Ka rrezik, që edhe në kryesinë e re të gjendet ndonjë që të mos i pëlqejnë këngët e vallet dhe të na e heqin prapë brigadieren.

Pas shënim: Këtë radhë, shqetësimi ynë që i kotë. Para ca ditësh në mbledhjen e përgjithshme kryesia dha llogari. U fol shumë. U fol për sukseset dhe për të metat. U fol edhe për brigadën tonë, që kishte arritur rezultate shumë të mira. «Brigada e nëntë mban flamurin, — u



tha, — dhe kjo në saje të punës së palodhur të brigadës dhe të drejtimit të mirë të brigadieses, shoqes Marie».

Ne shpërthyem në duartrokitje. Maria u bë flakë e kuqe si lule shege, ndërsa ca mendjemukur, që ishin aty pranë, ulën kryet si gjethe vjeshtuku e nuk e zgjatën më llapën.

Sivjet ne e kemi filluar përsëri punën mbarë. Briga-

da jonë mbahet në gojë, po tani jo më se i ndërron për çdo vit brigadierët, po sepse edhe ne dimë të dalim në krye e të nderohemi me flamurë.

— Maria, brigadierja jonë, — thamë ne njëzëri, — di jo vetëm të drejtojë mirë, por edhe të këndojë bukur.

Shkurt 1971

KUR PËRGJIGJET REDAKTORI

Vendosa të dëgjoja shokët. Domethënë vendosa të shkruaja një tregim, se ata një më dy dhe zdrukthin në kurrizin tim e shkonin.

Dhe, meqenëse vendosa, duhej pa tjetër të vritja mendjen edhe për personazhet e tregimit, për situatat që do të kalonin dhe për fatin që do t'i priste. Kjo kërkonte telashe të mëdha sepse, kur personazhet fillojnë e mbërthehen me njëri-tjetrin, ec e u shko pas në ke nge.

Sidoqoftë bëra si bëra dhe ia dola në krye. Them ia dola në krye gjithmonë sipas mendimit tim, se, sa për të tjerët, shohim e bëjmë se, si i thonë, dardha e ka bishtin prapa. Kështu edhe tregimi im. Kishte prapa bisht e krye e jo vetëm bishtin.

Në qendër të tregimit vendosa dy të rinj, domosdo të sekseve të ndryshme, sepse duhet të njiheshin, të miqësoheshin, të bënin dashuri dhe të fejojeshin. Kështu duhej, sepse me lajmës nuk i pleksja dot. Le që zor se gjeja edhe një lajmës. Edhe po të takoja me ndonjë, hajde dhe të gjeja këtu në Myzeqenë time dy prindër, një nga djali e një nga vajza, që do të merrnin shkopin në dorë si njëherë moti e do të trokitnin në derë të mikut me një fjalë në gojë: «Sqepari, or mik, nuk e gdhend vetë bishtin e tij. Për këtë punë duhet një sqepar tjetër. Bijtë m'u rritën. Duhet të gjëllini ju për ta e jo unë.» Megjithkëtë, them se do ti gjeja dy të tillë, në mos prindër, së paku gjyshër, po a e ndreq dot me të rinjtë se? Ata do të

më çoheshin drejt për drejt dhe hajde të duroja yryshin e tyre. Të ishte fjala për ndonjë kritikë vetëm për vetëm, hajde de, po, po sikur të më qepeshin më tej me ndonjë kritikë në kolektiv ose me ndonjë fletërrufe? Apo i jep kokë kollaj fletërrufesë! Apo të kursen edhe mbledhja e Frontit! Ta çon djersën tragës së kurrizit gjer në thembër të këmbës ajo. Të shkund sikur të kesh ngrënë njëqind shufra thane.

Kështu pra, e pashë të udhës që të kem në qendër të tregimit dy të rinj. Djalin e quajta Agim dhe vajzën Agime. I quajta kështu: se edhe ngjarja zhvillohet në agim sepse, siç dihet, ai që martohet shpejt, ai që ha bukë shpejt dhe ai që shkon shpejt në mulli, del gjithmonë i fituar. Në mëngjes bëhen të gjitha të mirat. Edhe njëherë moti, kur pazari bëhej ditën e martë, kush e bënte pazarin në mëngjes, dilte i fituar. Pasdite thoshin: «Aksham pazar, bataqçi mall.»

Ashtu mëngjes, mëngjes, në një ditë të bukur plot diell, se duket dielli që në mëngjes, i mora dy të rinjtë, atje në aksion tek ishin (aty duhet të dashuroheshin pa tjetër, sepse kështu shkruajnë disa poetë në vjersha) dhe i vura të punonin afër njëri-tjetrit. Eh! Veç t'i shihnit, or miq. Punonin të dy pranë e pranë si dy pëllumba (jo si ata që mbajnë në kafaz), i buzëqeshnin njëri-tjetrit, ia bënë edhe ndonjëherë fap me sy, kur qeshnin, kur tregonin qyfyre ose kur hidhnin rromuze dhe pastaj, kur lodheshin, uleshin pranë e pranë, po pa u cikur me njëri-tjetrin, për të mos i dhënë shkak ndonjë thashethemexhiu, që në këso rastesh mbushte kapanonet plot me zëra korbash: «E morët vesh? Ai me atë, ashtu, ashtu, domethënë kështu e kështu», dhe fërkonte gishtërinjtë tregues të duarve për t'u dhënë të tjerëve të kuptonin se dy të rinjtë e kishin pleksur bashkë.

Si kaloi ca kohë, i bashkova. Dhe e gjeta rastin. I

lashë një ditë vetëm. Parë ishin. Biseduar kaq herë kishin. Njohur e stërnjohur ishin. Rrënjë e degë kishin zënë. Shkurt i kishin njohur njëri-tjetrit karakterin. Edhe buzëqeshjet dhe të qeshurat nuk i kishin rreshtur. Edhe bashkë kishin kërcyer kaq herë e ia kishin shtrënguar dorën njëri-tjetrit. Tashmë nuk u mbetej gjë tjetër veç të flitnin. Dhe ata folën. Dhe, kur folën, në fillim e zunë me zë të mekur, duke shkullur ca fije bari, duke vështruar vjedhurazi njëri-tjetrin e pastaj, kur e gjetën fjalën, domethënë kur gjetën një gjuhë të përbashkët, zbrazën gjithë thesin duke nxjerrë mjaltë e sheqer nga goja dhe mjalti mori dhenë aq, sa shokët organizuan një mbremje argëtimi e aty i përgëzuan dy të rinjtë që hodhën poshtë zakonet e vjetra.

Si i fejova, i lashë në punë të tyre. Të punonin e të gëzonin së bashku. Kur kënaqeshin ata, unë përse ta trashja tregimin? Ata ishin të lumtur dhe unë atëherë i urova si gjithë të tjerët, u këputa një të trashëguar, ashtu vençe e me gjithë gjongël u thashë: «Edhe në kokë të të tjerëve!» I vura në zarf, (ta merr mendja, tregimin dhe jo ata vetë), zarfit i shkrova adresën për në organin ku më rekomanduan shokët, i ngjita edhe një pullë nga ato të emisionit të fundit me një buburrecë në mes dhe e çova vetë me dorë te nëpunësja e postës.

— Dërgoje sot, — i thashë, — se kështu e kështu e kam punën, — dhe ajo nuk ma ktheu fjalën por e futi që atë çast në thes të postës.

Zarfi u nis në një krah dhe unë u ktheva në krahun tjetër. Prit e prit e kjo u bë si ajo përralla me mbret që, pa kaluar tre vjet, tre muaj, tri javë e tri ditë, Qerosi nuk e vriste dot kuçdrën.

— Tani që e dërgove tregimin, — më thoshin shokët, — prit. Të tjerat vijnë vetë.

Dhe unë, duke pritur që të tjerat të vinin vetë, rrija

c mbaja vesh nga dera se mos dukej postieri për të kërkuar mushtullukun.

Sa ditë kaluan kështu as unë nuk e di. Di vetëm se harrova ditën kur e kisha nisur zarfin dhe dalngadalë fillova të harroja edhe ç'kisha shkruar në të. Dhe tamam atëherë kur i kisha humbur të gjitha shpresat, përgjigjja erdhi dhe unë thirra me sa zë pata, aq sa postieri u lemeris, ktheu majat nga thembrat e fluturoi duke folur me vete: «I shkretë Tasi. Çartisi nga fiqiri më duket.» Po unë e pata nga gëzimi. Nuk thonë kot: «I duruari, i fituari.» Dhe atje në redaksi janë burra si qëmoti. Dhe e çela zarfin. Brenda ishte një copë letër. Në copëzën e letrës ishte shkruar:

«Shoku Tasi,

Tregimin tuaj e lexuam. Na pëlqeu shumë. E kishit shkruar bukur e me fantazi. Duket se keni talent. Po vetëm se kemi një vërejtje të vogël. Mendojmë që në tregimin tuaj si personazh kryesor të mos jenë gjyshi me gjyshen dhe të mos u tregojnë nipërve një përrallë me mbret, se këtyre lloj përrallave u ka ikur koha. Si e qysh, të tjerat rregullojini vetë në përshtatje me kërkesat e kohës!

Të fala shoqërore
Hysen Hyseni»


Unë mbeta gojëhapur. E pritja këtë përgjigje me një frymë dhe mbeta pa frymë. Kështu më gjetën shokët kur erdhën.

— Hë? — më pyetën.

Unë u drejtova një kundërpyetje.

— Ore miq! A s'më thoni, ju lutem, për pleqtë a për të rinjtë shkrova unë?

- Për të rinjtë, — më thanë ata.
— Po personazhet e tregimit tim, pleq a të rinj ishin?
— vazhdova.
— Të rinj.
— Po ky këtu ç'thotë?
Dhe u dhashë letrën. Ata e lexuan dhe ngrinë në vend.



— Ti, në qendër të tregimit kishe dy të rinj, o Tasi, po, perderisa redaktori thotë se kishe një gjyshe dhe një gjysh, që u tregojnë nipërve përralla me mbret, duhet ta besosh edhe ti se ashtu duhet të ketë qenë me të vërtetë.

Dhe shtuan:

— Jetojmë në shekullin e çudirave, o Tasi vëllai. Dhe redaktori nuk ka faj. Gjersa u futën të rinjtë në zarf, sa shkoi zarfi në redaksi, sa qëndroi në dosjet e sirtarët e redaktorit e le pastaj në dosjet e punonjësve të tjerë të redaksisë, ta merr mendja që u plakën dhe thuj shyqyr se, po të kishin mbetur edhe ca aty dhe redaktori të mos i kishte nxjerrë, me siguri do ta kishin dredhur bishtin e do t'ia kishin lënë shëndenë kësaj bote.

Dhe e lamë me kaq.

Prill 1972

BËJMË DASMË NE!

Ishte e enjte, ditë e zakonshme pune, po në fshatin tonë bëhej dasmë. Dasma po si dasmë, me raki, me meze e me dollira, që vinin varg e varg si rruazat e inxhisë.

Dita e dasmës ishte prerë aty e ca kohë më parë.

— Të enjten do ta marrim nusen, — kishin thënë, — kështu ka qenë zakoni e ne nuk do të kthehemi sot nga nojmat e reja.

— Ashtu vërtet. Ashtu kemi bërë qëmoti. Ashtu e thoshte edhe kanuni.

— Se mos na thonë gjë, ore, se mban ca si erë fe kjo dasmë kështu, ditën e enjte?

— Hëni ju, hëni! As mos e shkoni ndër mend atë! Te ne shumica e dasmave të enjten bëhen.

— Të enjten, të enjten. Nuk jemi me fëshfëshe ne. Jemi me zakonin. Fëshfëshet le t'i mbajë kush të dojë.

Kështu dasma kishte mbetur për të enjten dhe ja sot te kërciste sazja e daullja, kënga kishte marrë dhenë dhe gjuha u qe zgjidhur dasmorëve. Fjalën e kishte marrë një krushk që, në raki e sipër, fap ia kishte bërë qeleshes mënjanë dhe kishte thënë duke iu drejtuar të zotit të dasmës:

— Dasmën do ta bëjmë ashtu, socialiste që i thonë. Dhëndrri të vejë e ta marrë vetë nusen. Nuk jemi fanatikë ne.

— Dhëndrri ore, posi. Nuk mbahemi më lidhur pas

gjalmës së vjetër. E këputëm atë dhe e pastë për hije të saj atje ku e kemi hedhur.

— Hë, më të lumtë goja, or mik!

Dollibashi u ngrit më gjunjë.

— Të pimë për shëndetin e mikut, që ma pati fjalën e gojës hoje mjalti, — sokëlliti dhe u dha njëherë mustaqeve me të prapë të dorës. — Jo vetëm dera jonë, por i gjithë fshati ynë nuk është fanatik. E kemi luftuar fanatizmin ne. Edhe fesë i kemi dhënë dërmën e na marrtë të ligat. Hajde, gëzuar!

Kur erdhi ora, krushqit ia hipën makinës dhe të gjithë u nisën për të marrë nusen.

Makina ecte si shigjetë. Thëllimi të thante, po krushqit vazhdonin dollinë duke ngritur faqoret e rakisë. Kur hynë në fshatin e nuses, aty ia morën këngës dyshe, aq sa u shkul i gjithë fshati për t'i parë.

Si i bënë zakonet një e për një, e hipën nusen në makinë. Në kokë i kishin hedhur një duvak dhe ia kishin mbuluar fytyrën. Shoferit, Fetahut, nuk iu durua:

— Hiqjani nuses duvakun, — u tha. — Nuk ka lezet kështu! Pse, në kohë të osmanllinjve jemi?

Dikush nga pala e vajzës e vështroi ngultas.

— Ti, o shofer, mos na i prish zakonet, — i tha ai, — se kjo puna e zakonit, që ta dish hollë-hollë ti, është si puna e midesë. Njëri e honeps kështu e tjetri e honeps ashtu. Ne do të mbajmë zakonin që na lanë gjyshat. Ju andej nga fshati juaj bëni si të doni.

Ia priti një krushk:

— Si ju, si ne, njëlloj jemi. Zakoni është zakon.


Dhe nusja qëndronte majë kamionit mbuluar me duvak.

Shoferi ia shkeli gazit duke murmuritur:

«Hajde Turqi, hajde. — Dhe i vinte plasja tek e shihte nusen me duvak. — Pa le, deshën të më jepnin

edhe të pija. Të bukur dolli që do të ngrija. Dollinë e duvakut».

Vonë arritën në fshat. Makina u ndal pranë shtëpisë. Kishin dalë për të pritur nusen një taborr me das-



morë. Këndonin të gjithë, të mëdhenj e të vegjël. Nusen e zbritën nga makina për ta hipur në kalë. Dikush tha:

— Pse ta hipim nusen në kalë? Ja tek është shtëpia. Le ta marrë dhëndrri për krahu.

Një plak, me të dëgjuar këtë fjalë, pështyu tri herë si për të larguar nga vetja një të keqe të madhe. Një tjetri iu drodh cepi i mustaqes, ndërsa i treti, me dellin e ballit kërcyer përtpjetë, u hodh e urdhëroi:

— Mos na prishni zakonet. Hipeni nusen në kalë!

Po dhëndrri kishte arritur më parë se fjala e plakut zakonlli. Ai e kishte rrokur nusen prej krahu. Shokët dhe shoqet e kishin rrethuar. Kënga buçiste me forcë. Sazexhinjtë gati sa nuk po i shqyenin veglat. Krushqit vinin pas. Të gjithë këndonin e, mbi të tjerët, dëgjohej zëri i të rinjve.

— Hajde, jepi rini! Forca! Të na trashëgohen!

Nusja me dhëndrri ecnin përpara. Duvaku ishte hedhur pas. Pas kishte mbetur edhe plaku zakonlli.

Dikush e goditi me bërryl:

— Kanë ardhur ditë të reja, — i tha. — Ditë të reja me zakone të reja.

Ai e vështroi vëngër dhe pa i kthyer përgjigje, i zymtuar eci zvarrë-zvarrë në drejtim të dasmorëve.

Mars 1972

KUSH I MBUSH MENDJEN PULIJES?!

Mit Longari ishte ulur në prak të derës dhe po grinte një dorëz duhan. E shoqja, Pulija, dy çape matanë, xheç punonte, ndërsa njëri prej fëmijëve, Lili, vinte vërdallë, fliste, qante, qeshte. Fëmijë ishte dhe, si gjithë moshatarët e tij, nuk bënte as më shumë e as më pak. Po të pyetësh hollë-hollë, në gjithë lagjen e mbanin në gojë për të urtë. Po ku i mbushej mendja Pulijes.

— Kush, ky? Për këtë thua zotrote, që është qengj i perëndisë? Ua! Të gënjen mendja! Zog i largneshit është ky, më thuaj, pa e di unë sa i urtë është. Ai të pëlçet shpirtin, që plastë në vend si kokërr rrushi!

Dhe, kur ndodhte që ndonjëra nga shoqet ia priste fjalën dhe i thoshte :«T'u thaftë goja, moj Pulije, si e mallëkon djalin kështu?!» — ajo as që e bënte qejfin qeder, po përgjigjej si nëpër gojë:

— Hë, hë, se nuk e gjen gjë vulëhumburin! Ku ka mortje të merret me të, që e marrtë ai i lumit, më keq nga ç'e ka marrë!

Po të zinë Miti na e kishte gjetur kjo bela. Fundja kishte një rreth me fëmijë. Ç'të bënte? Kishte dhënë e kish-te marrë me të shoqen, po ajo veç i kishte shtuar mallëkimet, se për t'i pakësuar as që e vriste mendjen. Pa kur ndodhte që, vërtet rrallë, ai e qortonte, ajo ia priste si me sëpatë:

— E, or ti, ç'i thashë de, që ia thënçin pas rrëzës së veshit!?

Dhe Mit Longari ishte mësuar të mos e dëgjonte më, po ta duronte. Veç edhe durimi ka kufi. Ndjaj i shkruhej nganjëherë:

— Moj po lëre djalin rehat!

Atëherë Pulija tërbohej fare.

— E lashë, e lashë, që ma lënçin pa sy!

Miti sikur ia kishte hequr fillin dhe atë ditë, kur po grinte duhan me biçak, dëgjonte dhe nuk nxirrte zë. Pulija jepte e merrte me Lilin, që vazhdonte të qante.

— Mbylle gojën! Ty të them, që ta thënçin! Mbylle, t'u mbylltë gryka!

Po Lili qante dhe lëvizte sa andej-këtej. Pulija vazhdonte breshërinë e mallëkimeve.

— Po pse luan nga vendi, more, që luajç nga trutë! Po rri aty ku të lëshova unë, ore, që më të lëshofshin nga shkëmbi! — dhe mori djalin për ta vënë pranë karriges, po ai ra. Atëherë iu shkreh: — Re, që të rëntë një damblla? E shikon, ore? — iu drejtua të shoqit, — hiqma qafe këlyshin e derrit! Merre ngrohe në shullë, që e ngrohshin ethet e gushtit!

— E, mjaft de, mjaft! Mjaft, se...

— Nuk e gjen gjë, jo. Nuk e gjen gjë këtë qen të zgjebosur, që ka zënë e qan ë, ë, ë, që ëngla i rëntë!

Kur mbaroi së griri duhanin dhe e mbushi kutinë mirë e mirë, Miti mori djalin në krah e doli ta shëtiste.

Po Pulija atje në shtëpi, edhe pse e mbetur vetëm, vazhdonte të mallëkonte:

— Ikën, që u ikshin mendtë e kokës! Pa le pastaj kur të vijnë, që u ardh të pas koke! Më lidhën këtu brenda, që i lidhsha me litar!

Kështu ngrysej dita.

Dhe, kur binte fjala, Mit Longari dinte ç'nxirrte nga goja:

— Ashtu, shpirt, ashtu. Po t'u bë rrësk në derë një grua që e nis dhe e bitis ditën duke mallëkuar, shtëpinë në majë të shkopit ma ke kur të duash.

Po kush ia mbush mendjen Pulijes se?!...

Janar 1967

KUR E KE MIZËN NËN KËSULE...

Atë ditë, në gazetë u botua skica humoristike «Më mirë një vezë sot sesa një pulë mot». Njerëzit që e lexonin atë, shponin njëri-tjetrin me bërryl:

— Po të shpuar që e paska bërë. Edhe ne këtu e kemi një të tillë.

— A thua të jetë X?

— Mund të jetë edhe Y!

— Mund të jemi edhe ti, edhe unë.

— Tyt, more!

Gazetën e lexoi edhe ai që e kishte mizën nën kësulë. E lexoi dhe xheç i dogji, ndaj edhe hodhi dorën për të kruajtur kokën.

«Hëm..., — mendonte, — me mua e ka. Duket sheshit. Dhe i thotë vetes shok. Të bukur shok, mashallah. Dale, pa më sheh. Do të më njohë se kush jam.»

Dhe doli në rrugë.

I dukej sikur të gjithë e shihnin, sikur të gjithë e shënonin me gisht dhe pëshpëritnin:

— Ja, po shkon ai, njeriu që ecën me vrapin e kërmillit, që mendon me shpejtësinë e shkresave dhe të telegrameve që nis, saherë që vihet në marrëdhënie me të tjerët.

Veshët iu skuqën. Iu skuq edhe hunda, që i zgjatet si piperkë djegëse. Filloi të kërciste dhëmbët (paçka nëse kjo kërcitje nuk dëgjohet siç dëgjohen gjëmimet e gjëmave që ai bën, saherë që ndokush i shkel sinorin) dhe

do ti? Ja që i del përpara ai që ka shkruar skicën. E ndal.

— Me leje, shoku shok. Hëm... Si t'ju them... Lexova skicën tuaj humoristike. Bukur e kishit shkruar. S'kam asnjë vërejtje për shkrimin. Fjalën e kisha te heroi i skicës. Hëm... si t'jua them... Ka fjalë, vëlla, ka fjalë. Thonë se atë skicë ju e keni shkruar për mua.

— Po ju, ç'thoni?

— ?

— E pse pikërisht për ju e jo për ndonjë tjetër?

— Ku ta di unë. Kështu thonë, ndërsa unë. Unë ju pyes ju: Për mua e keni shkruar?

— Nuk e di. Mundet për ju, mundet edhe për ndonjë tjetër, mundet edhe për të gjithë ata që e kanë mizën nën kësulë. Mua nuk më shqetëson kjo. Më shqetëson më tepër qëndrimi juaj.

— Qëndrimi im? E pse?

— Sepse interesoheni shumë për të gjetur adresën e një shkrimi pa adresë.

Ai zbardhi dhëmbët.

— Ehe... Kështu duket.

Pastaj pyeti përsëri:

— Domethënë nuk qenka fjala për mua?

— Nuk e di.

— Mirëpo, po më thonë se qëndrimin tim do ta shqyrtojë organizata-bazë e Partisë.

— Kjo është punë që i takon organizatës e jo mua.

— More vëlla. Pritma troç. Jam, apo s'jam unë?

— Po ty pse të djeg?

— Që të mos digjem.

— Kjo varet nga përqindja e djegies.

— Këtu ta kam edhe unë. — Njeriu me mizën nën kësulë është shumë i shqetësuar. — Ç't'u them, po ma ngritën këtë problem në organizatë?

— U thuaj që s'je ti, në qoftë se e ndien veten që nuk



je ti, ose u thuaj që ti je, në qoftë se e ndien me të vërtetë që je vetë dora.

— Domethënë edhe ashtu, edhe kështu?

— Edhe kështu, edhe ashtu. Rëndësi ka fakti që për çdo shkrim të nxjerrim mësim. Skica nuk i drejtohet akësecilit po gjithsecilit.

Ai largohet, kësaj radhe duke shtrënguar grushtet.

— Ka për të më parë. Po kush i ka bërë të gjitha këto sa të sheh syri në tregti, more, kush? Unë i kam bërë. Unë i kam bërë të gjitha. Pa mua asgjë nuk bëhet e nuk bëhet. Ah! Ka për të më njohur. Do të ngre gjithë tarafin më këmbë. Do të marr hak. Është prekur thellë nderi dhe dinjiteti im, i familjes sime, i fisit, i fshatit, i krahinës, i rrethit. E, kur janë prekur këto, është prekur nderi dhe dinjiteti i vendit. Do të më njohë. Mos më thëngjin ky që jam, ky që më thonë, po nuk i hëngra mëlçitë!

Tjetri, ai që kishte shkruar skicën, nxori bllokun e shënimeve dhe shkroi: «Sot takova njeriun që kishte mizën nën kësulë. Ishte tip mjaft interesant. Ia vlente të shkruaje për të edhe një komedi».

Pas dy ditësh, tek ai erdhi një anëtar i byrosë së organizatës-bazë të Partisë të ndërmarrjes.

— Ju falemi nderit, — i tha, — ju na ndihmuat me atë skicën tuaj. Ne e shqyrtuam atë në organizatë dhe nxorëm dobësitë e punës sonë dhe të qëndrimit tonë ndaj punës dhe ndaj njerëzve.

Ai që kishte shkruar skicën përsëri nxori bllokun e shënimeve dhe shkroi: «Goditje në shenjë».

Qershor 1968

**«NË PLAN THONË, ME QINDRA JANË,
PO KOTECËT ASGJË S'KANË.. !»**

Janë apo s'janë? Kjo është kryesorja. Plani thotë: «Janë». Nga fshati përgjigjen në mënyrë po aq lakonike: «S'janë».

Ne që pyesim, mbetemi në dilemë.

Ai që e di se si qëndron puna, shtrihet në shullë, rrëzë një dëllinje dhe zë e këndon:

*«Në plan thonë, me qindra janë,
po kotecët asgjë s'kanë.»*

Fol atëherë më shtruar, djalli ta marrë! Në planin e prodhimit është shkruar qartë, pastër dhe me shkronjatë mëdha: Pula gjithsejt 600.

Ai që e di se si qëndron puna e që rri shtrirë në shullë, rrëzë një dëllinje, ia kthen përsëri po me këngë:

*«Mjeri unë për mend e mia,
Nji kët' punë e di kryesia.»*

Dhe unë shkoj në kryesinë e kooperativës bujqësore, ku llogaritari i kooperativës nis e ligjëron, veç zëri i tij nuk më ngjan si ligjërata bilbili:

— ...Pula the, ë? 600 the, ë? Janë, vëlla, janë, po janë në plan e jo në kotecë. Le që ne nuk kemi as kotecë, o lum miku. Dhe kemi arsye. Përse t'i hyjmë këtij telashi?

Pa merre me mend njëherë! Duhet ndërtuar kotecë, pa duhet ndërtuar në vende të përshtatshme, hap një kllapë këtu e thuaj se na duhet të zëmë e të kërkojmë shteg më shteg për të gjetur një vend të tillë, sikur të mos kishim punë të tjera po veç të merreshim me pula; pa duhet vënë edhe një rojtar që t'i ruajë nga dhelprat, hap një kllapë edhe këtu dhe thuaj, se dhelprat këtu te ne të lënë me gisht në gojë. Pa le pastaj që duhet edhe ushqyer, hap një kllapë edhe këtu dhe thuaj, që ne mezi po ua dalim me ushqim lopëve e jo të rrimë e të vrasim mendjen e të merremi e me se pa, me ushqim pulash! E kupton edhe vetë, o lum miku. Punë pulash është kjo. Ka, s'ka, njëlloj është. Jo po ec dhe mbaj edhe hesape, të lutem: Jo sa pula ranë kllaçka, jo po sa zogj dolën, jo po sa vezë u pollën, jo po sa u thyen, jo po sa i hëngrën dhe thanë «humbën», jo po sa zogj e pula iu bënë pajë dhelprës, ku e di unë. Jo, vëlla, jo. Kemi mjaft telashe të tjera!...

Llogaritari pushon ligjëratën, merr frymë thellë dhe unë i ngul një bodecë:

— Po fshatarët, a kanë pula?


Ai buzëqesh dhe më flet si me qortim:

— Oj kanë, thotë. Kanë dhe kanë nja 2000 krerë. Po të mos qe fshati, ku do të hanim ne? Fshatarët i kemi me mend, vëlla. Dhe hap një kllapë këtu, janë me mend thuaj, që kurse ua dinë kimetin pulave. Fundja, edhe këtu hap një kllapë, nuk është ndonjë gjë e madhe. Një shtëpi i mban katër a pesë pula, po një kooperativë si kjo jona nuk ka nge t'i pjellë groshi me gjashtëqind pula. Më vonë ma plotësuan «kuadrin historik» të peripecive të pulave. Në fillim kishin pasur ca pula. Pastaj, ngaqë i quajtën «belara», vajtën e u humbën yulën. Hë, hë dhe pas ca vitesh, i vunë prapë dhe prapë u ranë me kosore. Tani janë përsëri më të thatë. Për ata, kanë kooperativistët.

Ia kanë ndier lezetin. Ç'të bëjnë? Punë shije është kjo.
Atëherë zhvilloj një dialog të vogël.

Unë: — Po kur nuk kishit ndër mend të krijonit sektorin e shpendve, pse planifikuat që gjatë këtij viti të kishit gjashtëqind pula?

Llogaritari: — Sepse kërkohej në plan.



Unë: — Po kur do t'i keni?

Llogaritari: — Durim. Do të rregullohet. Vetëm mjekra e qoses nuk gjen ilaç.

U ndamë. Unë vritja mendjen: «Mirë llogaritari i kooperativës, që pret sa të gjejë ilaç mjekra e qoses, po kryesia e kooperativës ç'bën?»

Ke parë ti që m'u faneps ai, që e dinte se si qëndronte puna e që rrinte shtrirë në shullë, rrëzë një dëllinje, e më tha:

— Jemi meraklinj të mëdhenj pas pulave ne këtej.
— Dhe më shkeli synë.

Dhe unë shkova në atë kooperativë me shpresë se do të flitnin mirë për zhvillimin e shpendve. Ja, kështu u gënjeka njeriu!

— Ku ndodhi kjo? — thatë.

— Në një kooperativë bujqësore.

Argumenti:

«I ha dhelpra!»

Shkurt 1967

TUTJE ME GJITHË ESTRADË!

Andrea, drejtori i shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore kishte dy ditë që ishte në hall të madh. Më së fundi pasi e brodhi mendjen poshtë e lart, vendosi:

— Do t'i çoj në kooperativën bujqësore «Fitorja». Atje edhe përgjegjësi i vatrës së kulturës është një xhevahir djalë, që s'ia gjen shokun. Copa bëhet për artistët. Artdashës i madh, jo llafe.

Dhe pa e zgjatur mori receptorin.

— Alo? — iu drejtua me të butë centralistes, me të cilën i kishte lidhur mirë nyjet e marrëveshjes, — na jep «Fitoren». Alo? «Fitorja»? Përgjegjësin e vatrës së kulturës duam. Përgjegjësi je? Sa mirë! Unë jam Andrea. Po, po drejtori i kulturës, që mos qofsha! Planin e shfaqjeve për fshatin nuk e kam realizuar. Dua ta çoj trupën e estradës në fshat që të japë shfaqje dhe mendova, meqë ju njoh e ju kam si rreth miqësie, t'jua çoj sonte atje. Ju jeni të thekur për një çikë shfaqje? Apo nuk lini kokën për estradën! Prandaj dërgoni makinën të merrni artistët!

— Kë, artistët? — u dëgjua zëri matanë fillit.

— Po, po artistët. Janë bërë gati, vetëm makinën presin.

— Dëgjo këtu, drejtor vëllai. Ti mirë e ke, se fundja aty të rreh, pa më pyet mua se! Mua po më digjet mjekra, e ti më thua dale të ndez cigaren. Dëgjo, Andrea. Nuk kemi nge as të përçapemi e jo të rrimë dy orë në shfaqje. Jo, vëlla, jo. Është punë që s'bëhet kjo. Le pastaj që na

kërko edhe makinë. Bah, bah! Makinës nuk po i zënë rrotat dhé! A e di ç'ke ti? Lëre fare atë shfaqjen se po na bën mendja firifiu. Shohim e bëjmë ndonjëherë tjetër...

— Po kooperativistët duan të shohin shfaqje!

— Aq u thotë atyre, po mua po më luan tepeleku i kokës.


Andrea kishte mbetur gojëhapur nga çudia. Deshi të fliste, po tjetri ishte larguar nga telefoni.

— Po tani? Befas i shkrepri një mendim.

«E dija. Ai përgjegjësi i vatrës së kulturës i «Fitores» kurrë nuk e ka dashur artin, po unë desha t'i bëja qejfin. Lëri more, që të vënë mend e të kërkojnë pastaj vetë. Me ata të «Begatisë» ndryshon puna. Ata gjithmonë e kanë dashur estradën. Ata edhe përgjërohen për kokë të estradës. Atje do t'i çoj.»

Dhe i vendosur rrahu përsëri telin.

— Andrea jam, Ali. Do t'ju çojmë estradën, prandaj dërgo makinën të marrë artistët!



— Tutje ore, me gjithë estradë!

— Je në vete? Te ti i kisha të gjitha shpresat!

— Gabim e ke. Tjetërherë duhet të parashikosh edhe disa shpresa rezervë, se nuk i dihet si i del punës.

— More, po t'ju japim një shfaqje në drekë, — ngulli këmbë Andrea.

— Në drekë nuk jepet shfaqje, Andrea, se punojnë njerëzia, nuk e kanë mendjen te shfaqja si e kenë ju aty, që merreni me këto punëra. As pushim nuk bëjnë njerëzia. Varda puna, ore, varda po të them.

— Atëherë e japim shfaqjen në darkë.

— Në darkë? Hajde mendje, hajde! Në darkë njerëzia kanë hall të flenë, ore, e jo të merren me estradë.

— Po për pushimin e kulturuar të njerëzve, për dëfrimin e tyre të organizuar, mendohet aty te ju?

— Ç'qenke i ngeshëm, o Andrea. Ta thashë: Tutje me gjithë estradë e mos na bjer më qafë kot. Hajde, mirë u pafshim!

Andrea zgurdulloi sytë.

«Faj kam unë që merrem me këta. Unë e di sa u digjet shpirti për kohën e lirë të njerëzve këtyre të «Begatisë». Po ne jse, thuaj. Më shkau. Shko, more derdimen, çoje estradën në «11 Janari». Atje të presin krahëhapur...

Dhe kërkoi kooperativën bujqësore «11 Janari».

— Alo? Andrea jam. Andrea këtu në shtëpinë e kulturës. Na dërgoni makinë se do të vijë estrada te ju. Estrada, dëgjon? Do ta tundim fare. Do të japim numra nga më të zgjedhurit e do të shkulen njerëzia së qeshuri.

Tjetri nuk e la të vazhdonte më gjatë.

— Po ik tutje me gjithë estradë, se na ka ardhur shpirti në majë të hundës! Dhe estradën kemi mangut!

— Dëgjo, dëgjo këtu, — i tha, — mos ma prish mua. Për kokën tënde, dërgo atë makinë dhe merri, se kam mbetur si peshku më të thatë.

Tjetri ra ngushtë.

— Mirë, veç ta kemi fjalën. Vetëm një shfaqje të japin dhe të ikin se na bëjnë harbi fshatin.

— Si të duash ti. Mjaft që t'i shoh të marrin udhën e fshatit, pa... — Dhe Andrea, i mbytur në djersë, u shtri në kolltukun e zyrës, duke e përfunduar frazën e lënë përgjysmë: «Pa... u bëftë ç'të bëhet!»

Mars 1972

PO VIJNË TË DELEGUARIT...

Automobili, si ngjiti me të gulçuar të përpjetën e Qafës së Shkozës, mori teposhtë dhe e mbajti vrapin para zyrës së kryesisë të kooperativës bujqësore. Kryetari i kooperativës çeli derën, zbriti me rrëmbim dhe u fut në zyrën e tij gjithë tërsëllëmë, saqë ata që e pritnin te dera dhe u futën pas tij, mbetën si të ngrirë.

Kryetarit i shkonin djersët rrëke. Sado që ai shkonte herë pas here shaminë e bërë xurxull, përsëri djersët e mbulonin.

— Çileni, more dritaren, — turfulloi, — çileni, more, dritaren, se na mori shpirtin vapa!

— Është prill akoma, o shoku kryetar, — i tha një brigadiere, që kishte ardhur të qante hallet se nuk i dilnin të gjitha forcat në punë.

— Prill pa prill, djersët po na rrjedhin tragës së kurrit si në korrik.

Tjetri heshti. Kryetari vazhdoi:

— Nuk kemi nge tani për prill e për djersë. Njofto urgjent shokët e kryesisë, ata që ndodhen këtej rrotull, dhe për një orë dua t'i kem të gjithë këtu!

— Po unë kam një hall, o shoku kryetar.

Kryetari e ndërpreu.

— Nuk ka hall më të madh se ky që më ka zënë mua, prandaj luaj e mos e zgjat më tej!

Brigadieri doli jashtë. Kryetari iu drejtua dy të tjerëve:

— Po ju? Ç'pritni? Nuk e shihni që po thërres me urgjencë mbledhjen e kryesisë?

— Unë kam ardhur për problemet e eksperimentimit shkencor...

— Pas mbledhjes, pas mbledhjes...

— Po me qendrat e emulacionit nëpër sektorët ç'të bëjmë? — guxoi tjetri.

Kryetari s'u përmbajt.

— Pas mbledhjes, more, ju thashë, dëgjoni, apo jo? Hajt... — dhe u bëri shënjë të largoheshin.

Të tjerët e kuptuan që kryetari nuk e kishte të mbarë tagjinë dhe u kthyen nga erdhën duke e tërhequr derën pas krahëve.

Pas një ore kryesia me ca mungesa të «arsyetuara» kishte zënë vend rreth tryezës. Kryetari qe ngritur më këmbë.

— Çështja ka karakter urgjent, — thoshte, — duhen ngritur gjithë njerëzit më këmbë. Nata do bërë ditë. E kuptoni apo jo? Do të vijmë të deleguar nga rrethi për të parë se si është organizuar te ne propaganda e prodhimit. Ku ta dish? Mund të vijmë nga çasti në çast dhe është turp të na gjejnë të papregatitur. Merrni të gjitha masat e nevojshme që, kur ata të ndodhen këtu, gjithçka të shkëlqejë. Pregatituni edhe për ndonjë diskutim, se ku ta dish. Mund të provokojnë edhe ndonjë mbledhje. Nuk duhet të gjendemi gafil.

— E nga t'ia fillojmë më parë? — pyeti brigadieri që ishte bërë korrier.

— Ti filloje nga mobilizimi i forcave, meqenëse e paske edhe problem. Të gjithë duhet të dalin në punë. Duhet marrë shembulli nga brigada e parë. Shko pyet, shkëmbe eksperiencë, bëj siç kanë bërë ata, mblidhi njerëzit dhe, në qoftë se të deleguarit do të vijmë te ti, u thuaj se si rezultat i një propagande të tillë të fuqishme

e bindëse me njerëzit arrite në përfundimin e dëshiruar.

Pastaj u kthye nga një tjetër.

— Mos harroni edhe eksperimentimet shkencore. Duhet t'u tregojmë të deleguarve se si në brigadën e dytë u arrit të merren 80 kv. misër për ha. Kjo është një fitore e madhe.

— T'ua tregojmë të deleguarve apo brigadave të tjera, që ende nuk e njohin përvojën e brigadës së dytë?

— Hëpërhë t'ua tregojmë të deleguarve, — vërejti kryetari, që e gëlltiti këtë thumb duke mos e dhënë veten se i kishte djegur keq si gjemb murrizi, — dhe, kur të ikin ata, shohim e bëjmë. Pastaj biem në qetësi dhe e organizojmë si duhet shpërndarjen e përvojës së brigadës së dytë. E qartë?

— Po me qendrat e emulacionit?

Kryetari foli përsëri:


— Qendrat e emulacionit të rifreskohen që këtë çast. Nga janë e nuk janë, arsimtarë, nxënës e gjithë ata që u zë dora për të vizatuar, të fillojnë e të vizatojnë plane e grafikë dhe të vendosen në qendrat e emulacionit në sektorët. Mos harroni të vendosni edhe fotografitë e të dalluarve! Kini kujdes qendrën e emulacionit të sektorit të parë! Këtu e ca ditë të shkuara kam parë aty fotografitë e të dalluarve, që ishin vjet. Të rifreskohen të gjitha, morët vesh? Të rifreskohen të gjitha!

— Ka më? — pyeti një vajzë e re.

— Jo, kaq. Tani, o burra në punë dhe faqja e bardhë!

Tërë ato ditë njerëzit punonin si në ethe. E filluan me rregullimin e gjendjes së objekteve social-kulturore. U ngritën dhe u sollën aty plot fëmijë. Një plakë kishte kundërshtuar.

— E mbaj vetë nipçen, — i kishte thënë të birit, — e nuk e çoj atje. — Po ai ia kishte prerë yryshin:



— Jo, nëno, jo, atje fëmijët i mbajnë mirë e kujdesen për lodrat, për ushqimin, për shëndetin.
Plaka që bindur. Në kopshtet e çerdhet filluan të

ndiheshin britmat e gëzueshme të fëmijëve. Kjo gëzoi pa masë edukatoren, që e ngrysnin ditën me 4-5 fëmijë.

Të tjerët ishin mbledhur në qendrat e emulacionit. Ca jepnin udhëzime, ca diskutonin këto udhëzime, ca arrinin në konkluzione dhe «piqtorët» bënin punën. Dalngadalë qendrat e emulacionit po merrnin pamje të re.

Agronomi në një zyrë po jepte e po merrte dhe po pregatiste «referatin» «Si e kemi përgjithësuar përvojën e brigadës së dytë në kultivimin e misrit» dhe po e mësonte përmendsh për t'ua «referuar» të deleguarve, ndërsa kryetari ishte kyçur në zyrë për t'u «argumentuar» të deleguarve «punën e madhe» që kishin bërë për gjallërimin e propagandës së prodhimit dhe të emulacionit socialist.

Fshati qe gjallëruar. Të gjithë ishin vënë në lëvizje, që nga i madhi gjer tek i vogli. Ardhja e të deleguarve ishte bërë problem i ditës. Njerëzia veç ata kishin në gojë. Kryetari merrte e jepte duke dhënë urdhra pas urdhrash e kënaqej tek shihte atë ndryshim rrënjësor «në formë dhe në përmbajtje», siç thoshte.

Dhe, ndërsa ishte në kulmin e «krijimtarisë» së tij, dikush erdhi dhe i njoftoi: «Të deleguarit nuk vijnë sepse kanë shkuar në një kooperativë tjetër».

Kryetari u vrenjt dhe kërciti dhëmbët tërë inat:

— Hëm! Na shkoi gjithë kjo djersë kot!

Dhe, si për ta ngushëlluar veten, shtoi: — Megjithatë, prapësepapë të fituar dolëm. Propaganda e prodhimit dhe emulacioni u gjallëruan dhe u ngritën në një shkallë më të lartë.

Ca gra e vajza, që u ndodhën aty atë çast, thanë:

— Shoku kryetar! Nikoqirja e mirë, themi ne gratë, shtëpinë e mban në rregull çdo ditë e jo vetëm atëherë kur i vijnë mysafirët.

Kryetari i vështroi vëngër...

Shkurt 1971

EDHE TI?!...

Xha Trifoni e kishte bërë zakon që, sapo dielli ngrihej lart një litar samari, merrte lopën nga kasollja, e nxirrte në udhë, i ngjaconte kapistallin dhe hidhej matanë mezhdës së ugarit për të marrë një bark diell e për të kullotur syrin se, në atë moshë që kishte ardhur ai, këmba e dora nuk i punonin si më parë, po syri ishte lakmitar i madh për të parë tërë ato ndryshime që ndodhnin para tij.

Si ulej rrëzë ndonjë plisi a në ndonjë gropore bërë si furrik pule, ai nxirrte çibukun, i hidhte një dorë duhan, i vinte eshkën e, kur tymi niste të dilte shtëllungë-shtëllungë si në oxhak gjemije, ai e hidhte këmbën mbi gju, kapërcente për nën gju shkopin dhe e treste vështrimin tej, atje ku punonin kooperativistët, gra e burra bashkë.

Kollitej shpesh. Edhe ai vetë nuk e kuptonte se nga i vinte kjo e kollitur. Ia shkaktonte ai i uruar duhan vjeshtak, grirë si sallatë, që i ngacmonte mushkëritë e ngarkuara që i kërcisnin si motor, apo ishte pleqëria ajo që bënte të sajën. Sidoqoftë kjo nuk e shqetësonte shumë.

«E hëngra çairin unë, — thoshte. — Rrojta, pa u plaka. Po u plaka me terbiat ama, e jo si...»

Dhe e kthente vështrimin sa andej-këndej për të parë ndonjë vajzë a nuse të re veshur me pantallona e pa fustan mbi të.

«...Si këto që më dalin kështu. Vitheshkundurat!
Ehua!»

Dhe niste të fliste xha Trifoni, të fliste për jetën dhe për «modën» dhe masën e merrte që nga plaka e tij.

— Ajo po, — thoshte. — Kur shkante ajo, veshur me linjën gjer në fund të këmbëve e me shami lidhur një gisht përmbi vetull, gjakun ujë dhe syrin bakër ta bënte. Po ato vite shkuan e vanë. Qofshin për syfet të tyre, se edhe ashtu nuk kishte lezet. Po edhe kështu ama, me pantallona veshur e pa fustane mbi to, nuk shkon fare. Seç na kanë dalë ca çupa tani e na i kanë përvjelë edhe flokët e janë bërë si kokëzogëza e nuk i dallon dot në janë çupa a çuna.

Si e yshte mirë e mirë fjalën dhe hiqte tri-katër herë gjyrykun e çibukut, vazhdonte:

— Po ç'është kjo kështu? Të shkon gruaja në punë veshur me pantallona si të jetë mashkull dhe nuk ta vesh fustanin që të dallojë nga të tjerët. I veshën pantallonet? Mirë bënë. Me hak e patën, se edhe gërvishen tek punojnë ugareve, pa edhe nuk është mirë të hedhë bishtin e syrit tjetri, tek punon ti ashtu, kërrusur mbi shat, po... fustani do veshur ama. Fustani është për gratë. De, o bela, de. Sot është një, që del me pantallona veshur e pa fustan mbi të, po nesër na bëhen dy e më cazë shtohen aq, sa na prishin edhe bukurinë e fshatit. Ptu! Ta marrë djalli ta marrë! Pa ta zë njërën e ta shqep në dru, që t'i thyej brinjët, t'i thyej, ja kaq më vjen!

Kështu fliste kur kishte ndonjë njeri pranë. Kur ishte vetëm, tundte kokën, e ngulte vështrimin thellë, hiqte tymin e duhanit, dhe, kur shtëllungat merrnin përpjetë, ia shtronte me vete:

«E sheh more? Më duket se kaq e pati edhe kjo punë. Më mirë rruaj mustaqet dhe varja maçokut, se ai është burrë vërtet e nuk e lë macen të vishet si t'i dojë qejfi».

Mendja i shkonte tek e mbesa. Po sikur edhe ajo të vishet si këto kokëzogëzat që vijnë e flasin çapras. «Po u veshe me pantallona, mos e vish fustanin sipër, se dukesh si laraskë!» Posi. A thua se edhe ajo?...

Po shpejt e largoi këtë mendim.

«Bah! Vishet ajo kështu, pa... ia këpus kokën unë! I vë fre unë, që mos të më dalë nga freri, — dhe shtonte: — Le që nuk e bën veten ajo. Ehu, çfarë mbese që kam unë. Nuk e harron lehtë ajo se ç'ka hequr gjyshi në kohë të bejlerëve dhe nuk ia prish kurrë gjyshit, ajo. Edhe luftën që bëri i ati nuk e harron. Është çupë me mend në kokë ime mbesë dhe jo si këto...»

...Një ditë, xha Trifoni kishte dalë si zakonisht ndanë mezhdës.

— Pres mbesën, — i kishte thënë një kooperativisti që kishte shkuar aty pranë dhe kishte marrë udhën e ugarëve për të punuar së bashku me shokët. — Vjen sot nga aksioni.

Dhe për t'i bërë shteg mendimit të tij, iu kthye nipçes, që pak më tej mblidhte lule beçke:

— Dëgjove? Vjen jot motër sot. Ajo po, ajo është çupë për kokë të çupës e jo si këto kokëzogëzat.

Përkundrajt tij vinin një grup vajzash e djemsh. Këndonin. Era e merrte këngën dhe e shpërndante ugarëve, atje ku punonin kooperativistët e kënga e të rinjve përzihej me këngën e punës, duke formuar një melodi të tillë, që ta mbushte zemrën me një dehje të thellë. Qeshnin të gjithë. Qeshnin dhe këndonin nga gëzimi. Xha Trifoni po i vështronte me vërejtje.

— Hëm!... — pëshpëriti. — Si hargalisen të hazdisurit... Po, po... kështu e kanë këta të rinjtë... Tërbojnë... — dhe shtrydhi sytë. — Pa shiko, pa shiko. Qenkan të gjithë me pantallona veshur. Edhe vajzat. Edhe fustanet

nuk i paskan veshur përmbi pantallona. Turp, turp i madh. Vajza me pantallona e pa fustan mbi të, turpëron fshatin. Nga më dolën përpara tani, që pres edhe mbesën... Ma përsëndytën gjithë oreksin, të xhindosurit. Tyt, bela, tyt!

Deshi ta vazhdonte më tej mendimin, po njëra prej vajzave iu hodh në krah e ai padashur e shtyu dhe një zë i çjerrë, i papërmbajtur i doli nga thellësia e fytit.

— Tyt, bela!

Po çupa nuk iu nda.

— Gjysh! — thirri fort ajo dhe filloi ta puthte me mall. — Gjysh! Ke dalë të më presësh?

Ai fërkoj sytë.

— Ti?

— Unë, gjysh. Erdha. Mbaruam. E shch? Kam dalë pesë herë sulmuese.

— Ti, erdhe? — xha Trifoni fliste me zor.

— Erdha, gjysh, nuk më shch?

— Erdhe? Erdhe veshur vetëm me pantallona e pa fustan mbi të? Ku e ke fustanin?

— Ja, gjysh. E kam në valixhe.

Xha Trifoni nuk e dëgjonte, po i buçisnin veshët.

— Edhe ti...? Edhe ti kështu si çunat?

E mbesa qeshte me të madhe. Qeshnin edhe shokët e shoqet rreth saj.

— E pse jo, gjysh? Ç'të keqe ka kështu? Atje në hekurudhë ne e diskutuam këtë problem dhe vendosëm që të vishemi siç na ka hije e jo si sorra. Kur vishemi me pantallona, s'ka pse të veshim përsipër edhe fustanin. Kështu luftojmë konceptin konservator: «Fustani e dallon gruan që është grua. Fustani është për të».

Xha Trifoni nuk fliste më. Padashur, i tërhequr nga e mbesa, kishte hedhur mezhdën dhe i hiqte këmbët zvarë drejt shtëpisë. E mbesa fliste tërë entuziazëm.

— Sa i mirë je, o gjysh, sa i mirë je...

Ai nuk e dëgjonte.

«Veshur me pantallona, — mendonte, — me pantallona dhe pa fustane mbi to. Ëhë! Edhe ime mbesë, ë? Ëhë! Aq e pati edhe kjo, ë?»

E mbesa qeshte. Ajo ishte e gëzuar.

Xha Trifoni ecte pas së mbesës.

NJERIU ME DY FYTYRA

Atë pasdite kolektivi u mbledh në sallën e këndit të kuq.

— Siç jeni njoftuar, sot do të diskutojmë mbi problemin e emancipimit të gruas, — tha kryetari i komitetit profesional të ndërmarrjes. — Do të bëjmë një debat të gjerë. Secili ka çfarë të flasë.

Mbledhja kishte rëndësi të madhe e secili kishte ç'të thoshte, po ta fillonte këtë që nga vetja dhe të dilte pastaj te shoku. E vërteta, është se kishte nga ata që i trajtonin keq gratë në shtëpi, që silleshin me to si zotër të plot-fuqishëm, po kishte gjithashtu edhe të tjerë, që mund të përgjëroheshë për kokë të tyre, në mënyrë të veçantë kur i dëgjoje tek flisnin aq bukur e tregonin se sa mirë shkonin me gratë, si u ndihmonin në familje dhe si kishin arritur të vendosnin një mirëkuptim të shëndoshë, që edhe tërmetet nëntë ballëshe nuk i tundnin dot.

Kur filluan diskutimet, Thomait nuk iu durua më, por u ngrit e foli i pari. Gjaku i zbriti menjëherë në fytyrë, rrembat iu frynë dhe hunda iu skuq si ndonjë pipërkë qarrëse. Që në fillim që i pa përnibajtur, «kali revanin e jep që në nisje». Dukej sikur atë çast kishin shpërthyer të gjitha energjitë e tij, që i mbante të ndrydhura me saraqineska të fuqishme, për të mos i harxhuar kot. Fjalët mudohej t'i rridhnin të vrullshme, plot kumbim, me një theks të tillë, që te secili të krijonte një bindje për ato që thoshte.

— E kuptoni se ç'don të thotë të nderosh e të respektosh gruan, more shokë? Po gruan more, gruan, që na e mbush shtëpinë plot me gëzime. Po gruaja është vetë jeta, more, është vetë shtëpia. Ke grua, ke shtëpi. «S'ke grua, s'ke shtëpi.

Fliste me pasion. Tregonte se si ai për gruan ishte gati të jepte edhe gjysmën e jetës (ta merr mendja, po të qe se ajo do të paraqiste një kërkesë të tillë). Pastaj, po të ngulte këmbë ajo më shumë, ai mund të hiqte dorë fare edhe nga jeta, mjaft që ajo të mos dëshpërohej e ta hidhte në arbitrazh për mosplotësimin e kontratës së martesës.

— Amani, more shokë, — thoshte dhe djersët që i kishin mbuluar fytyrën i rridhnin palë-palë e i merrnin tatëpjetë gushën me tri palë rrathë, — duhet të jemi të ashpër e të pamëshirshëm, more, ndaj cilitdo që e trajton gruan si skllave, more, që sillet me të si ndonjë xhandar, si ndonjë satrap. Jo ta kritikojmë, jo, se me një kritikë e me një autokritikë ai hedh një hendek e mbyll një shteg, po ta dërrmojmë, more, ta bëjmë petë lakrori, që të mos e marrë veten sa të jetë gjallë. Ja kështu them unë dhe kështu duhet të jetë.

Dhe u ul, nxori shaminë nga xhepi, e shkoi njëherë mbi qafë e nën gushë e pastaj, si i ra një herë ballit me të shpinën e dorës, zbërtheu jakën e këmishës dhe nisi të bënte fresk.

Ata që e vështronin ashtu, si të kishte dalë nga një kaldajë, miratonin gjithçka tek ai. E kishin dëgjuar të fliste edhe herë të tjera për këtë problem, po si këtë radhë nuk e kishin dëgjuar asnjëherë. Dhe ai, që atje ku ishte ulur, e kuptonte se kishte tejkaluar çdo parashikim.

— Tamam burrë! — tha një andej nga salla, duke u anuar pak nga shoku që i qëndronte pranë. — Lum ajo grua që e ka. Ky ia shton jetën, ore, ia zbardh fare. —

Dhe, si të qortonte veten, vazhdoi: — Se edhe kështu si bëjmë ne, nuk është fare e udhës. Ka punë shtëpia e ne as që duam t'ia dimë. Hej, sa të prapët që jemi!

Ishte ngritur një tjetër. Po bënte autokritikë. Të gjithë kishin tendosur veshët.

— Shokë. Thomai foli drejt. Ne nuk sillemi si duhet në familje. E ç'jemi ne? Unë e ndiej gabimin thellë, shokë. Jam sjellur edhe në mënyrë arrogante ndonjëherë, duke mos e përfillur mendimin e gruas. Kam gabuar. E pranoj dhe do të përpiqem që raste të tilla të mos ndodhin.

U dëgjuan duartrokitje. Në drejtim të tij vërshuan buzëqeshjet.

— Të lumtë, — i tha Thomai, që ishte në një rresht pas tij. — Fole si burrat. Ja, ashtu duhet. Të zhvishemi, të zbërthehem, t'i kuptojmë thellë gabimet se vetëm kështu do t'i përmirësojmë ato.

Mbledhja mori fund në orët e vona të mbrëmjes. Kur morën të dilnin, Thomai i vuri krahun kryetarit të komitetit profesional e të dy morën udhën e shtëpisë.

— E kupton? — thoshte Thomai. — Këto janë probleme të mprehta. Po nuk u sqaruan ideologjikisht një-rëzit, nuk do të jenë kurrë në gjendje të kuptojnë detyrat e tyre në këtë fushë kaq të rëndësishme të veprimtarisë shoqërore.

— E kuptoj, — i përgjigjej kryetari, një babaxhan njeri, që në ndërmarrje e mbanin në gojë për ndershmërinë e tij të thellë që e karakterizonte, — dhe ne nuk do të mjaftohemi vetëm me një debat. Biseda të tilla do të organizojmë herë pas here. Besoj se ju, shoku Thoma, do të na ndihmoni.

— Pa dyshim. Asgjë nuk do të kursej.

Kur arritën pranë shtëpisë së Thomait, ishte errur. U ndanë. Kryetari i komitetit profesional bëri përpara, ndërsa Thomai ngjiti shkallët, qëndroi para derës së hyrjes

së apartamentit, rregulloi xhaketën, shtrëngoi kravatën, ngriti dorën dhe me okëzën e gishtit tregues goditi tri herë, shënjë konvencionale kjo, që deshifrohej kështu: «Erdhi kreu i shtëpisë. Të gjithë të vihen në gatishmëri numër një. Mjerë ai që do të guxojë të ngrejë zërin pa marrë më parë lejë nga unë».

E shoqja nxitoi të çilte derën.

Ai i hodhi një vështrim me bisht të syrit, kapërceu pragun, eci rëndë-rëndë dhe, si hoqi këpucët, veshi pantoflet dhe shkoi e u ul në një kanape, përballë televizorit.

Vrenjti vetullat.

— Kush e ka hapur televizorin? — pyeti duke u munduar ta përmbante veten. — Vdiqa unë?

E shoqja, në këmbë, duke u marrë me përgatitjen e darkës, u përgjigj:

— Të pritëm, po ti u vonove. Atëherë unë...

Ai i ra tavolinës me grusht e u çor aq fort, sa u dëgjua në anën tjetër të murit, në apartamentin fqinj.

— Mbylle zgurdën, të thashë! Mbylle, se do të ta mbyll unë, dëgjove? Jam gjallë unë. Nuk kam vdekur akoma. Këtu jam zot unë. Unë jam kreu e ti je bishti dhe bishti në bisht ka për të vdekur. Kuptove?

Ajo foli me zë të butë.

— Ti nuk ke të drejtë, Thoma.

Ai u ngrit po nuk mundi të hidhte një çap përpara. Në derë kishte qëndruar komshiu.

— Ju kështu, shoku Thoma? Ju që flisni aq bukur dhe dini ta trajtoni aq mirë temën mbi emancipimin e gruas?

Thomai u mundua të buzëqeshte, po komshiu ishte larguar duke e lënë atë në mes të dhomës, pa ditur në duhej të ngrinte dorën kundra gruas, apo të ulej. Preferoi këtë të fundit, duke hedhur një raketë në drejtim të së shoqes.

— Mbylle kamaren, të thashë, se me atë gjuhë nuk e ke të gjatë!

Të nesërmen ai doli në punë si zakonisht. Në hyrje të ndërmarrjes të gjithë e vështronin çuditërisht jo si herët e tjera. Nuk i buzëqeshnin ashtu siç i buzëqeshnin një natë më parë.

Kur kapërceu portën e hyrjes, në të djathtë, aty ku ishte vendosur këndi i fletërrufeve, dikush kishte vendosur një fletërrufe. Ia drejtonte atij. I jepte një dush të ftohtë për sjelljen e pahijshme në familje. «Njeri me dy fytyra. Ja cili është Thomai. Kolektivi duhet ta analizojë thellë qëndrimin e tij», shkruhej në atë fletërrufe.

— Hëm! — shtrëngoi dhëmbët ai.

E lexoi përsëri. Firma ishte e komshiut.

— I poshtri, — pëshpëriti ai. — Mirë ma bëri, por do t'ia shpërblej edhe unë!

Dikush i kishte hedhur dorën mbi sup. U kthye. Ishte kryetari i komitetit profesional. Thomai i buzëqeshi.

— Mirëmëngjes...

— Mirëmëngjes, shoku Thoma. Sot kemi përsëri mbledhje. Do të marrim në shqyrtim qëndrimin tuaj në familje. Pregatituni.

Ishte mëngjes. Flladi frynte lehtë, Thomai ishte mbytur në djersë, këtë radhë jo më nga zjarri i diskutimit të tij me aq pasion, po nga zjarri i kritikës së shokëve. Ai e njihte mirë gjykimin e kolektivit...

TË RROJË SPITALI!...

I

Plaku i shtëpisë së Zogajve, xha Rakoja, ishte ftohur pak e nuk e ndiente veten mirë. Helbete. Plak njeri ishte dhe pleqtë janë si karta e cigares. Fryn era në majë të Tomorit dhe ata plevitosen në fushën e Myzeqesë. Kjo i shqetësonte të gjithë pjesëtarët e familjes. E donin shumë xha Rakon ata. E donin për urtësinë e tij, për fjalët e tij që i kishte të rënda si dërhëm kandari, për dashurinë e tij ndaj të gjithëve. Gjithsekush mundohej të bënte diçka për të, ose të jepte mendimin e tij, paçka nëse ia pranonin ose jo.

— Të rrijë brenda në shtëpi nja tri-katër ditë, — thoshte njëri.

— Të pijë çaj të ngrohtë, — thoshte tjetri.

— Ta fërkojmë me kamfur e t'ia fusim këmbët në ujë të ngrohtë me kripë dhe keni për të parë po nuk u ngrit qiçer fare, — ngulte këmbë djali i madh.

Të gjithë kishin të vetmen dëshirë: Ta shihnin xha Rakon në këmbë. Ta shihnin të shëruar e me bastun në dorë, të rrihte trotuarin e të merrte udhën andej nga klubi i veteranëve, ku pleqtë kalonin orët e tyre më të bukura.

Vetëm nusja e djalit nuk ishte aq entuziaste sa të tjerët dhe rrinte me buzët lëshuar. Ajo i dëgjonte ata që flisnin dhe duke ardhur rreth nëpër shtëpi, pëshpëriste me vete: «E kanë larg shtëpisë së tyre ata, ndaj dhe flasin

si e ëma e Zeqos majë thanës. Pa më pyet mua, se. Le që u mbyta në punë, po na ku më shpifet edhe sëmundja e vjehrrziut. Kush do t'ia bëjë shërbimin në shtëpi? Se kush është i zënë me punë. Edhe unë nuk kam nga ta mbaj frymën. Punët e zyrës duhen bërë, rrobat duhen larë, duhen nderur në tel dhe, si të jenë tharë, duhen hekurosur. Pa le pastaj që do gatuar edhe gjella. Domosdo, në këtë punë më ndihmon edhe im shoq, po ku ka duk puna e burrit!»

Ajo ecte poshtë e lart, vazhdonte të pëshpëriste me vete, vazhdonte të fryhej në vetvete dhe, kur ujët e «kapërceu» enën, ajo nuk duroi dot.

— Ohu edhe ju. Jeni mbledhur kokë më kokë si të qe një djalë i ri. Nuk e sheh! Keni frikë se mos ikën e na lë armët varur. Plak është ai. Të rrojmë edhe ne kaq, pa nuk duam gjë tjetër. Pastaj, ç'e zgjasni kaq? Kështu e ka ai, një më dy dhe tështin. Na spërkat gjithë ditën e ditës me jargë. Ja tek është spitali, xhane. Meqenëse e dashkeni kaq shumë, çojeni atje, ç'prisni? Mos vallë shteti i ka ngritur kot spitalet? Mos vallë i kemi spitalet që t'i shohim si bina më këmbë? Spitali për ato punë është, për të shëruar njerëzit. Sot është gjynah të qahet njeriu. Të rrojë spitali dhe shteti, që bën mjekimin pa para.

Të gjithë qëndruan si t'i kishte goditur rrufeja.

— Mos fole gjë, moj nuse? — e pyeti Katina, çupa e madhe e xha Rakos, që tërë ato ditë, që nga mëngjesi e gjer në mbrëmje vinte aty për t'i shërbyer të atit. — U rëndove?

— U rëndova, posi. Nuk është një ditë e dy. Ku i dihet se sa do t'i zgjatë sëmundja!

Xha Rakoja e dëgjoi, tundi kryet dhe u ngrit pak me zor.

— Më pregatit rrobat, bir, — iu drejtua djalit. —

Ka të drejtë nusja. Nuk është një ditë e dy, — dhe iu drejtua nuses, që e vështronte në heshtje, pa ditur nëse duhej të thellohej më tej në mendimin e saj apo duhej të heshte: — Ke të drejtë, moj nuse...

II

Një «i sëmurë» ka ardhur te mjeku. E shoqëron një plakë, që ecën duke u mbajtur fort pas shkopit dhe pas plakut. Rënkon. Me të mbërritur para derës, së një zyre, ata qëndrojnë.

— Hyr, — i tha plaka.

— Hyr ti, e para, të të shohë.

I «sëmuri» çel derën dhe futet brenda. Nëpunësja — vajza e tij — ngrihet rrëmbimthi.

— Qyqja, baba!

Plaka vjen pas tij, duke rënkuar. Vajza i drejtohet s'ëmës.

— Ç'ka babai, nënë? — dhe përsëri kthehet nga i ati. — Baba! Ulu, ja, ulu këtu. Ç'je bërë kështu në këtë ditë?

— Jam sëmurë, moj bijë. Nuk marr dot frymë. Më shoi astma, nefesi që i thonë. Ti e di fort mirë.

— E di e di, — përgjigjet e bija, — po, kështu e ka astma, baba. Të mundon ca, po fundja... Do shërbime sëmundja, baba, do përkujdesje.

— Do të shtrohesh në spital, bijë.

— Atje i bëhet më mirë edhe shërbimi, — shtoi plaka.

— Në spital? Ti në spital? Po çfarë ke për në spital, ti, baba? Nuk është mirë të shtrohesh në spital për gjëra të tilla.

— Epo... ç'të bëj, moj bijë? Pleqëria i ka këto...

— Po pse nuk e mbani në shtëpi, moj nënë? — ngul-

moi ajo. — S'është ky për në spital. Pak fërkim do, diçka të ngrohtë dhe ja ku e kaloi. Pse e lejoj nusia?

— Nusja?

E ëma e vështroi thellë

— Mos e ngatërro nusen, moj bijë, — foli i «sëmuri».

— Ajo m'u lut, nuk deshi të më linte, po ngula këmbë e i thashë: «Jo, bijë, jo. Të falem nderit, po do të shkoj në spital se atje e kam edhe krushkun Rako e të dy do ta kalojmë si do ta kalojmë kohën. Pleq jemi, dhe në e spërkatshim njëri-tjetrin me jargë, nuk na gjen gjë.

E bija ndjeu një goditje të fortë. Heshti për një çast. Pastaj u ngrit.

— Ejani, — u tha prindërve: — Eja, baba. Eja, nënë!

— Në spital? — e pyeti i ati.

— Po, — u përgjigj ajo — Ejani të shkojmë në spital të nxjerrim baba vjerrin. — Sytë iu mbushën me lotë. — Gabova, baba. Gabova, nënë. Më falni. Ai mund të shërohet fare mirë në shtëpi, po të jetë se ne do t'i shërbejmë si duhet.

I «sëmuri» zgjidhi peshqirin, me të cilin kishte lidhur kokën, drejtoi trupin dhe e rroku të bijën për qafe.

— Ja, kështu, bijë. — i tha. — Dëgjova se e çove krushkun në spital. Dëgjova edhe për fjalët që kishe thënë. Turp, thashë. Ime bijë ta bëjë këtë? Ia ndreq unë asaj. Dhe ta ndreqa, ë

Të tre morën udhën e spitalit, ndërsa në mbrëmje, të dy krushqit, xha Rakoja shtrirë në krevat e krushku pranë tij, kuvendonin shtruar për lehtësirat që ka krijuar shteti me gjithë këtë rrjet të gjerë të shërbimit sanitar e për kujdesin që duhet të tregojnë nuset për pleqtë e shtëpisë.

«DEGA E FORTË»

Asllan Suloja vendosi të fliste. Kjo ishte një e drejtë e tij, që ia siguronte ligji. Ai do ta shfrytëzonte këtë të drejtë ku të mundte e si të mundte. Madje, duke u mbështetur në këtë faktor, ai vendosi të fliste me zë të lartë, aq sa ta dëgjonin i madh e i vogël, se ai, Asllan Suloja, nuk ishte njeri që mund të merrej lehtë nëpër këmbë. Ai ishte njeri me një barrë mend dhe si i tillë dinte edhe ku t'i shiste këto mend.

Dhe, që nga çasti që vendosi të fliste, Asllani zuri të vriste mendjen se çfarë do të fliste. Dhe djersa nuk i shkoi kot. E gjeti çelësin për zgjidhjen e teoremës.

Një mëngjes shkoi e u paraqit atje ku duhej, për të filluar nga puna.

Në zyrë e priti një mesoburrë, i ardhur në fjalë e që të jepte pamjen e një babaxhani.

— Erdhët? Bëtë mirë. Ne kemi besim në forcat tuaja. Do të punoni si magazinier. Siç e shihni, puna është e mirë, — i tha dhe gjithë i qeshur në fytyrë i shkeli syrin.

Asllani rrudhi buzët.

— Unë magazinier? Unë? — dhe në mënyrë shumë kuptimplote i ra gjoksit me grusht. — Unë, Asllan Sulua, i biri i Sulos, që njihet prej të gjithëve, që...

Tjetri e ndërpreu i qetë.

— Po, ju. Ç'të keqe ka, nëse i biri i Sulos do të punojë si magazinier në një ndërmarrje?

— Punë që s'bëhet. Unë nuk mund të mykem si thasët nëpër depo. Mua më takon një punë tjetër. Im atë...

Dhe u largua tërë rremba, po pas ca ditësh trokiti përsëri në atë derë dhe përsëri nëpunësi babaxhan e priti me përzemërsi.

— Sa mirë që erdhët, — i tha. — Ja kështu duhet. U bindët më së fundi, ë? Po, kësaj here në magazinë nuk ju vendosim dot. Atje vendosëm një tjetër. Do t'ju dërgojmë të punoni në zyrën e planit të...

— Si, si? Në zyrën e planit, unë, Asllani, i biri i Sulos?

— Po, ju. Nuk ju pëlqen?

— As që e shkoj ndër mend të thartoj trutë me shifra që kur gdhihet gjersa ngriset.

— Na vjen keq, por...

— Të mos ju vijë keq fare.

Asllani bëri përsëri një gjysmë rrotullimi dhe u gjend shpejt-shpejt në rrugë duke folur me vete: «Unë, ë? Unë në zyrën e planit, ë? Unë i biri i Sulos, ë? Bah! Le të shkojë kush të dojë në plan, po jo unë».

E megjithatë, pa ç'pa, përsëri për të tretën herë u gjend përpara nëpunësit babaxhan.

— Po sikur të punoni në zyrën e llogarisë? — i propozoi ai, duke e vështruar kësaj radhe me një ndjenjë të thellë keqardhjeje. — Ç'thoni.

Asllani zgurdulloi sytë si maçok mulliri.

— Domethënë të nxjerr e të mbyll balance? E mbani për vete atë mendje. Ju po me çmëndni. Besa, më çmendët po ju them. Si nuk e kuptoni që unë mund të bëj vetëm punë speciale, ashtu «dente-lente» — dhe i theksoi si fort këto fjalët e fundit, duke i shoqëruar edhe me një lëvizje të dorës së djathtë, se të majtën e mbante vazhdimisht në xhepin e pantalloneve, që të dukej si njeri «i mësuar», si njeri «me kulturë».

— Pse, jeni i sëmurë? — e pyeti nëpunësi me atë çiltërsinë e tij të zakonshme.

— Po. Nuk e sheh? Mua po më digjet mjekra, kurse ti, çfarë bën ti? Ti më thua: «dale të ndez cigaren.» Nuk kam lindur unë për t'u marrë me punë dosido, jo! dhe aq më tepër me punë të tilla të rënda...

Deshi të fliste edhe më, po në derë u dha i ati, Sulloja, një burrë i nderuar e i respektuar nga të gjithë. Ai i hodhi një vështrim të birit dhe shkoi drejt e te nëpunësi. Të dy u përshëndetën si dy shokë të vjetër.

— E? — e pyeti. — Ç'thotë ky zog u im?

Nëpunësi iu përgjigj me një buzëqeshje të lehtë.

— Zogu? Ja ashtu si zog, më kërkon të fluturojë pa u ndalur në asnjë degë.

Asllani u krekos. I ati ishte aty. Domethënë, më së fundi ai kishte hequr dorë së thëni të birit: «Shko në zyrën e punës. Atje do të të japin një punë si gjithë të tjerëve.»

Tanimë ai kishte ardhur vetë e kjo qe një gjë e mirë. Domethënë ai kishte vendosur të mos qëndronte më sehirxhi ndaj të birit.

— Dega duhet të jetë e tillë, që të mbajë një zog si unë, — foli Asllani, i krekosur si ndonjë gjel fushe.

I ati u drejtua nga nëpunësi.

— Ai ka të drejtë, — i tha. — Unë kam gjetur për të një degë të fortë. Në rast se ju nuk keni kundërshtim, le të shkojë të punojë si punëtor në ndërmarrjen bujqësore. Tokat janë këtu pranë qytetit. Bujqësia ka punë të shumta. Ndryshe nuk themi kot që «bujqësia është çështje e të gjithëve». Atje, midis shokëve, midis arave, do ta ndiejë veten mirë.

— Në ndërmarrjen bujqësore? Unë bujk? — Asllani nuk u besonte veshëve. I ati ishte ky që fliste kështu?

Sulo Metushi, që kishte ngrënë barutin me dhëmbë, ishte ky që kërkonte për të birin punë në bujqësi?

— Po, ti. — i tha i ati, pa lëvizur asnjë qepallë. — Nga doraku i parmendës e kam nisur unë jetën, po jo në këto kushte, në kushte të tjera, në kohërat kur hahej buka dhe kafshohej dora. Nga doraku i parmendës nise edhe ti, që të mos e harrosh vlagën e tokës që të rriti, të mos e harrosh zanatin e parë të tyt eti.

I biri heshti.

Disa ditë më vonë ai u pa tek punonte në fushat e ndërmarrjes, duke prashitur pambuk, së bashku me shumë shokë të tjerë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Kështu mendoj unë	3
Operativi	7
«Berberi»	12
Gruaja jote, the?	16
Si kaposhi majë kurjakut	19
Novatori me takije	23
Këtu jam unë zot	30
Legjenda e derrave	33
Gjuhë llafazanësh	37
Brigada e tetë brigadierëve	39
Kur përgjigjet redaktori	44
Bëjmë dasmë ne!	50
Kush i mbush mendjen Pulijes?!	54
Kur e ke mizën nën kësulë	57
«Në plan thonë me qindra janë, po kotecët asgjë s'kanë..!»	61
Tutje me gjithë estradë!	65
Po vijnë të deleguarit	69
Edhe ti?!... ..	74
Njeriu me dy fytyra	79
Të rrojë spitali!... ..	84
«Dega e fortë»	88